



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 194 Akti

Nr. 209 Vendimi  
Tiranë, më 11.11.2019

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Firdes Shuli</b>	Kryesuese
<b>Alma Faskaj</b>	Relatore
<b>Pamela Qirko</b>	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 28.10.2019, ora 12:00 dhe 7.11.2019, ora 15.30 në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Hajrie Muçmata**, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, (në vijim Kushtetuta);

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Alma Faskaj, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Hajrie Muçmata, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, *ex officio*.

2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI) dhe Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ( në vijim DSIK).

3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 1, datë 3.10.2019, të trupit gjykues nr. 3, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 për të tria kriteret, vlerësimin e pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Me mirëkuptim u caktua kryesues i trupit gjykues, komisionere Firdes Shuli. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

4. Në datën 6.2.2019 subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi përbërjen e trupit gjykues, për të cilin në datën 7.2.2019 deklaroi përmes postës elektronike se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit me ndonjë nga anëtarët e trupit gjykues.

5. Në datën 4.10.2019, trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 2, vendosi të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Hajrie Muçmata, vetëm për kriterin e pasurisë, bazuar në rezultatet e hetimit për këtë kriter të paraqitura nga relatorja e çështjes.

6. Në datën 13.5.2019 trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, të paraqesë pretendime/sqarime shtesë brenda datës 22.5.2019, për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Në datën 18.5.2019 subjekti i rivlerësimit paraqiti një kërkesë për përfshirjen në procesin e rivlerësimit edhe të kriterit profesional, si dhe për rihapjen e hetimit.

8. Në datën 18.5.2019 subjekti i rivlerësimit dërgoi shpjegimet e tij mbi rezultatet e hetimit kryesisht në lidhje me kriterin e pasurisë.

9. Në datën 18.10.2019, trupi gjykues, me vendimin nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2019, vendosi mospranimin e kërkesës për rihapjen e hetimit dhe përfshirjen e kriterit të vlerësimit profesional, duke arsyetuar: “... në gjendjen që janë aktet dhe pas parashtrimeve të subjektit nuk jemi para një kërkesë të bazuar për rihapjen e hetimit, duke rezervuar të drejtën që pas shpjegimeve në seancë dëgjimore, trupa të çmojë përfundimisht rihapjen ose jo të hetimit të çështjes”.

10. Trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Hajrie Muçmata, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Me anë të postës elektronike,

subjekti iu njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 28.10.2019, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

11. Në datën 28.10.2019, ora 12:00, u zhvillua seanca dëgjimore ku subjekti i rivlerësimit ishte prezent. Në fillim të seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit paraqiti një kërkesë paraprake për përjashtimin e trupit gjykues.

12. Trupi gjykues vendosi ndërprerjen e seancës dëgjimore dhe dërgimin e kërkesës për shqyrtim nga një tjetër trup gjykues.

13. Trupi gjykues, i ngritur me vendimin nr. 33, datë 27.5.2019, lidhur me këkesën e subjektit për përjashtimin e trupit gjykues, në vendimin e tij ndër te tjera arsyetoi: *“Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ushtron funksionet e tij si institucion i pavarur dhe i paanshëm, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor, në përputhje me Kushtetutën, Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut si dhe ligjin nr. 84/2016.*

*Trupi gjykues çmon se për asnjë rast ushtrimi i detyrës funksionale dhe/ose mënyra e interpretimit dhe zbatimit të legjislacionit në fuqi, nuk përbën paragjykim dhe cenim të paanësisë së trupit gjykues dhe, për rrjedhojë, nuk mund të përbëjë shkak për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues, si e pa mbështetur në asnjë nga parashikimet e ligjit nr. 84/2016, ligjit nr. 44/2015, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Mbi parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.*

*Parimet e paanësisë dhe objektivitetit në gjykim, të parashikuara në nenet 6 dhe 39 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, nenit 42 të Kushtetutës nuk janë cenuar në këtë rast konkret nga trupi gjykues”.*

14. Me vendimin nr. \*\*\* prot., datë 29.10.2019, trupi gjykues i ngritur për të shqyrtuar kërkesën e subjektit për përjashtimin e trupit gjykues, vendosi rrëzimin e kërkesës së subjektit.

Trupi gjykues vendosi vazhdimin e seancës dëgjimore në datë 7.11.2019.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

15. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, znj. Hajrie Muçmata, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jabobs.

16. Gjatë seancës dëgjimore të datës 7.11.2019, subjekti i rivlerësimit, znj. Hajrie Muçmata, shprehu qëndrimin e saj lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni.

17. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, znj. Hajrie Muçmata, kërkoi konfirmimin në detyrë.

18. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Hajrie Muçmata. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 7.11.2019, për të rifilluar në datën 11.11.2019, për shpalljen e vendimit.

## **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

19. Znj. Hajrie Muçmata ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit ndaj saj, duke u përgjigjur dhe dërguar dokumentacionin dhe shpjegimet përkatëse sipas kërkesës së Komisionit, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj saj.

#### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

20. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

21.1 Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

21.2 Sipas kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

21.3 Sipas kreut V, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

21.4 Ndërsa, sipas kreut VI, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

21.5. Por, referuar në vendimin nr. 2/20171 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII, të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

#### **RIVLERËSIMI I PASURISË**

22. Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit ka kryer kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Hajrie Muçmata, duke krahasuar: deklaratën e pasurisë “Vetting”; deklaratat e pasurisë në vite; si dhe dokumentacionin justifikues bankar, jobankar etj., të dorëzuar nga subjekti me të dhënat e kërkuara me anë të korrespondencës pranë institucioneve publike. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja konstaton se për subjektin e rivlerësimit, znj. Hajrie Muçmata:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin,*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë,*
- *ka kryer fshehje të pasurisë,*
- *ka kryer deklarim të rremë,*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

23. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u vijua me hetimin administrativ për rivlerësimin e pasurisë së këtij subjekti dhe ligjshmërisë së burimit dhe të krijimit të saj.

24. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës “Vetting”, të paraqitur më parë pranë ILDKPKI-së, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Hajrie Muçmata.

25. Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

26. Procesi i rivlerësimit nga Komisioni për komponentin e pasurisë sipas neneve të kreut IV, dhe neneve 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, është bazuar në: (i) pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë “Vetting” të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur; (ii) pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratat vjetore të pasurisë për vitet 2003 – 2016 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur; (iii) hetimin e pasurive të personave të tjerë të lidhur; (iv) dokumentacionin e administruar nga hetimi administrativ; (v) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit, apo nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

27. Subjekti i rivlerësimit, znj. Hajrie Muçmata, e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë “Vetting” (duke përfshirë personat e lidhur), në datën 24.1.2017, në bazë të ligjit nr. 84/2016, fakt ky i konfirmuar nga ILDKPKI-ja nëpërmjet vërtetimit të lëshuar. Pra, subjekti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30 ditor nga hyrja e tij në fuqi.

Në deklaratën e pasurisë “Vetting” të vitit 2017 subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar këto pasuri dhe likuiditete:

**1. Apartament banimi me sipërfaqe 117.5 m<sup>2</sup>, ndodhur në Rr. “\*\*\*”, pallati \*\*\*, Tiranë, e blerë sipas kontratës së shitjes, datë 12.4.2006, prenotuar sipas kontratës së sipërmarrjes datë 18.3.2004<sup>1</sup>.**

Vlera 4.562.000 lekë. Pjesa takuese: 50 %.

Burimi i krijimit: kursimet nga paga në vitet 1995 – 2004 dhe bashkëshortit në vitet 1983 – 2004, si dhe një hua e marrë një shtetasi në vlerën 15.000 euro (pa kontratë).

**Faktet që rezultojnë nga hetimi administrativ kryesisht dhe provat e administruara**

---

<sup>1</sup>Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën certifikatë për vërtetim pronësie, datë 20.4.2006, për apartament me sip. 117.5 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, në pronësi të I. dhe Hajrie Muçmata: kartela e pasurisë; kërkesë për lëshim certifikate, datë 13.4.2006; kontratë sipërmarrjeje, datë 18.3.2004, për apartament mes porositësit I. Muçmata dhe shoqërisë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k. Çmimi i shitjes dhe shuma e paguar nuk janë të qarta pasi në kontratë ka shënime me shkrim dore nga ku rezulton se apartamenti ka sip. 126 m<sup>2</sup> dhe kësti i parë në vlerën 20.000 euro, datë 25 prill 2004, ndërsa nuk rezulton sa është vlera totale e shitjes së apartamentit. Gjithashtu, konstatohet se kontrata e sipërmarrjes ekzistuese ka qenë për apartament me sip. 71.4 m<sup>2</sup>, në vlerën 37.000 euro; kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 12.4.2006, për apartament me sip. 117.5 m<sup>2</sup> dhe 9 m<sup>2</sup>, ambiente të përbashkëta (total sip. 126.5 m<sup>2</sup>), nr. pasurie \*\*\*, lidhur mes blerësit I. e Hajrie Muçmata dhe shitësit, shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. Çmimi sipas kontratës në vlerën 4.462.000 lekë i likuiduar jashtë zyrës noteriale; planimetri e apartamentit; deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 23.4.2016, me deklarues M. B., për huadhënien e bashkëshortit të saj, E. B. (i cili aktualisht ndodhet në USA) të shumës 15.000 euro në vitin 2004, pa interes. Huamarrës I. M., shuma 15.000 euro është shlyer nga I. M. në vitin 2006.

Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në deklaratën e interesave private periodike vjetore të vitit 2004, ku subjekti dhe personi i lidhur, kanë deklaruar apartament banimi me sip. 126 m<sup>2</sup>, në vlerën 33.000 euro.

Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006 subjekti ka deklaruar se vlera e këtij apartamenti nuk është 33.000 euro por 36.425 euro, pas deklarimeve se subjekti kishte bërë disa punime shtesë.

Nga hetimi rezulton e provuar se në datën 18.3.2004, mes porositësit I. M., bashkëshortit të subjektit, dhe shoqërisë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k., është lidhur një kontratë sipërmarrjeje për këtë apartament. Në vijim me kontratën e shitjes, datë 12.4.2006, të lidhur midis shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe blerësit I. M., kjo pronë është regjistruar në rregjistrin hipotekor, si pasuria nr. \*\*\*, z.k. \*\*\*, f. \*\*\*.

### **Lidhur me këtë pasuri Komisioni hetoi në këto drejtime:**

#### **Lidhur me saktësinë e deklarimeve periodike dhe deklaratën “Vetting”**

Rezulton e provuar se në datën **18.3.2004** mes porositësit I. M. dhe shoqërisë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k., është lidhur një kontratë sipërmarrjeje për këtë apartament. Në analizë të këtij dokumenti shpresor, Komisioni konstatoi se ka shënime dhe fshirje si të sipërfaqes së apartamentit objekt shitjeje, ashtu edhe të vlerës së tij. Konkretisht, duke parë shënimet që kanë qënë para se të fshiheshin, nga kjo kontratë sipërmarrjeje rezulton se sipërfaqja e apartamentit ka qënë 71 m<sup>2</sup> (së bashku me ambientet e përbashkëta) dhe çmimi i shitjes ishte parashikuar 37.000 euro.

Nga kontrata e shitjes rezultoi se shuma e paguar dhe sipërfaqja nuk janë të qarta, pasi në kontratë ka fshirje të sipërfaqes dhe çmimit të shitjes, si dhe shënime me shkrim dore ku shënohet sipërfaqja 126 m<sup>2</sup>.

Sipas shënimeve të bëra në këtë akt rezulton se apartamenti ka sip. 126 m<sup>2</sup> dhe kësti i parë në vlerën 20.000 euro do të paguhej në datën 25.4.2004, ndërsa nuk rezulton se sa është vlera totale e shitjes së apartamentit.

Për sa më sipër, konstatohet se kontrata e sipërmarrjes fillimisht ka qënë për apartament me sip. 71.4 m<sup>2</sup>, në vlerën 37.000 euro (duke parë vlerat në fjalë të vlerave të fshira), por që ka ndryshuar pa qënë e qartë dhe pa u provuar me dokumentacion ligjor modaliteti i ndryshimit të kushteve të kontratës së sipërmarrjes mes personit të lidhur dhe firmës së ndërtimit në vitin 2004.

Mbi këtë pasuri, subjekti ka bërë deklarimin e parë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004, duke e deklaruar me një sipërfaqe më të madhe se kontrata e sipërmarrjes, pra, me sipërfaqe 126 m<sup>2</sup>, ndërkohë që deklaroi një çmim shitjeje më të vogël (33.000 euro), që nuk parashikohet as në kontratën e sipërmarrjes dhe as nuk përputhet me çmimin e blerjes së këtij apartamenti.

Gjatë hetimit të çështjes, Komisioni ka pyetur subjektin lidhur me këtë konstatim i cili me përgjigjen e dhënë ka shpjeguar, si më poshtë :

*“...apartamenti i banimit me nr. pasurie \*\*\*, me sipërfaqe 126 m<sup>2</sup>, (sipërfaqe e shfytëzueshme 117.5 m<sup>2</sup>) është pronuar nga ana jonë në vlerën 33.000 euro, shumë e cila është likuiduar dhe deklaruar në deklarimin e vitit 2004. Në përfundim të tij vlera e apartamentit të blerë sipas kontratës së shitjes (pas kryerjes së disa punimeve shtesë nga firma sipas kërkesës tonë) është 36.425 (tridhjetë e gjashtëmijë e katërqind e njëzet e pesë) euro ose 4.462.000 (katërmilion e katërqind e gjashtëdhjetë e dy mijë) lekë”.*

Për sa më sipër, nga analiza e dokumentacionit të administruar në dosje, nga deklarimet e dhëna dhe provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni konstatoi se:

Në deklarin e parë për këtë pasuri, të bërë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar një sipërfaqe më të madhe se kontrata e sipërmarrjes, pra, sip. 126 m<sup>2</sup> dhe ka deklaruar një çmim shitje më të vogël, 33.000 euro, që nuk parashikohet as në kontratën e sipërmarrjes dhe as nuk përputhet me çmimin final të blerjes së këtij apartamenti, i cili rezulton të jetë në vlerën 36.425 euro.

### **Lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie:**

Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar si burim të krijimit të kësaj pasurie:

- kursimet nga paga për vitet 1995 – 2004 dhe të bashkëshortit në vitet 1983 – 2004;
- hua e marrë një shtetasi në vlerën 15.000 euro (pa kontratë).

Lidhur me kursimet nga paga e subjektit për vitet 1995 – 2004 dhe të bashkëshortit në vitet 1983 – 2004 si burim të krijimit të kësaj pasurie:

Në vlerësimin e këtij burimi, Komisioni analizoi deklarinimet dhe sqarimet e subjektit të dhëna gjatë hetimit administrativ, në harmoni me dokumentacionin provues të administruar.

Konkretisht, subjekti është pyetur në lidhje me shlyerjen e pagesave për këtë pasuri, si dhe i është kërkuar dokumentacioni që disponon për këtë fakt. Për sa iu kërkuar nga Komisioni, subjekti ka sqaruar: “ .....pagesa prej 33.000 euro është bërë pranë zyrave të shoqërisë ‘\*\*\*’ që në momentin e pronotimit. Pjesa pjetër prej 3.425 euro është paguar nga ana jonë pranë zyrave të shoqërisë ‘\*\*\*’. [ .....] Unë nuk disponoj mandatpagesa të lëshuara nga firma ‘\*\*\*’ sh.p.k., pasi që nga momenti i nënshkrimit të kontratës së shitjes, ka kaluar një kohë relativisht e gjatë mbi 13 vjet ...”.

Rezulton se subjekti ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003 kursime *cash* në vlerën 26.200 USD, si dhe depozitë bankare në vlerën 200.000 lekë.

Gjithashtu, në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti ka deklaruar si burim për blerjen e pasurisë edhe një hua në shumën 15.000 euro, burim të cilin subjekti nuk e kishte deklaruar në deklaratën periodike vjetore të pasurive dhe interesave të viteve 2003 dhe 2004. Por, në vitin 2005, subjekti deklaroi se bashkëshorti i saj ka marrë një hua vlerën prej 18.000 euro, me qëllim blerje pronash në Tiranë, por pa specifikuar se për çfarë pronash apo pasurie ishin destinuar këto hua. Nga ana tjetër, personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në vitin 2004 ka deklaruar huan e marrë nga dy persona, E. R. B. dhe K. I. D., përkatësisht në muajt tetor dhe nëntor të vitit 2004. Por, të dyja këto hua, janë marrë shumë muaj më vonë se shlyerja e detyrimit ndaj firmës së ndërtimit me kontratën e sipërmarrjes datë 18.3.2004 (për të cilën subjekti deklaroi se pagesën prej 33.000 eurosh e ka likuiduar që në momentin e pronotimit).

Me qëllim realizimin e një analize financiare sa më reale dhe objektive, Komisioni mori në konsideratë deklarinimet e subjektit mbi shpenzimet dhe të ardhurat në harmoni me të gjithë dokumentacionin e administruar .

Sipas analizës financiare<sup>2</sup> të mëposhtme, rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë pasur mundësi të krijojnë gjendjen *cash* të deklaruar në vitin 2003.

Në vijim analiza financiare për periudhën 1995 – 2003

---

<sup>2</sup>Për të llogaritur shpenzimet e jetesës: viti 1995 - 2 persona \*5.000 lekë/muaj; viti 1996 -6 muaj 2 persona - \*5.000 lekë/muaj 6 muaj 3 persona \*5.000 lekë/muaj; vitet 1997, 1998 dhe 1999 - 5.000 lekë/muaj\*12 muaj; vitet 2000 dhe 2001 - 10.000 lekë/muaj \*3 persona; viti 2002 - 10,000 lekë/muaj \* 4 persona; dhe viti 2003 nga ILDKPKI-ja.

<b>Përshkrimi</b>	<b>Shuma në lekë</b>
Të ardhura subjekti	3.207.228
Të ardhura bashkëshortja	3.498.860
<b>Total të ardhura</b>	<b>6.706.088</b>
Blerë automjet tip “Benz” në vitin 2001	800.000
Shpenzime jetese	1.584.780
<b>Diferenca e mundshme për kursim</b>	<b>4.321.308</b>
Paguar këst lokali 15.000 euro (pjesa e I. M.)	2.004.750
26.200 USD ekuivalent në lekë + 200.000 lekë “Raiffeisen Bank”	3.047.678
<b>Diferenca</b>	<b>- 731.120</b>

Për sa më sipër, referuar kësaj analize financiare subjekti rezulton me një bilanc negativ në vlerën prej 731.120 lekesh, pasi ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për krijimin e likuiditeteve të deklaruara në deklaratën periodike vjetore të vitit.

### **Lidhur me huan e marrë një shtetasi në vlerën 15.000 euro (pa kontratë) :**

Nga hetimi ka rezultuar se:

1) Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar huan prej 15.000 euro, e cila në deklaratën “Vetting” parashikohet si një nga burimet e krijimit të pasurisë apartament. Gjithashtu rezulton se në këtë deklaratë, nuk ka deklaruar detyrimin financiar për këtë hua.

2) Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004 të bashkëshortit të subjektit, personit të lidhur i cili ka qënë subjekt deklarues sipas ligjit për shkak të detyrës si oficer i policisë gjyqësore, përmendet për herë të parë një hua e marrë nga dy persona E. R. B. dhe K. I. D., përkatësisht në muajt tetor dhe nëntor të vitit 2004.

3) Për herë të parë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005, subjekti ka deklaruar se bashkëshorti i saj ka marrë një hua prej 18.000 euro, por me qëllim blerje pronash në Tiranë, pa përcatuar se cilën/at pronë/a.

Gjate hetimit administrativ nuk u provua me dokumentacion shkresor se kur është bërë shlyerja e detyrimit për blerjen e apartamentit, pasi nga subjekti nuk është vënë në dispozicion dokumentacion shoqërues. Subjekti, siç edhe evidentohet më sipër, ka deklaruar se: *“Unë nuk disponoj mandatpagesa të lëshuara nga firma “\*\*\*” sh.p.k., pasi që nga momenti i nënshkrimit të kontratës së shitjes, ka kaluar një kohë relativisht e gjatë mbi 13 vjet. Me administratorët e shoqërisë ‘\*\*\*’, te të cilët kam blerë apartamentin, me gjithë përpjekjet e mia për t’i kontaktuar, nuk kam arritur të komunikoj pasi nga të dhëna në QKB më rezulton që kjo firmë nuk është aktive”*.

Për sa më sipër, nga analiza e dokumentacionit të administruar në dosje, nga deklaratimet e dhëna dhe provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni konstatoi se:

- Huaja e deklaruar në deklaratën “Vetting” në vlerën prej 15.000 euro, nuk mund të konsiderohet si burim i ligjshëm për krijimin e kësaj pasurie.
- Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë për huan në vlerën 15.000 euro si burim të apartamentit të banimit, pasi kjo hua deklarohet se është marrë disa muaj më vonë se shlyerja e vlerës së tij prej 33.000 euro.

Pavarësisht faktit se dy huat nga shtetasit E. R. B. dhe K. (K.) I. D., nuk mund të jenë burim i krijimit të pasurisë dhe si të tilla ato nuk janë përfshirë në analizën financiare të kryer nga Komisioni, në lidhje me pasurinë apartament ndodhur në Rr. “\*\*\*”, Komisioni çmon se bazuar



në pikën 14, të nenin 3 dhe në pikën 3, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, këta shtetas plotësojnë kriteret ligjore për t'u kualifikuar si “*person tjetër i lidhur*”, duke mbartur detyrimet që i ngarkon ligji për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

Nga hetimi administrativ i kryer rezulton se pavarësisht deklarimeve në vite të marrëdhënies së huas, ajo me personin tjetër të lidhur, znj. M. B., është formalizuar me një akt noterial në vitin 2016, pra, jo në kohën reale të lindjes së kësaj marrëdhënie. Në ILDKPKI subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 23.4.2016, me deklaruese M. B., për huadhënie shumë 15.000 euro në vitin 2004, pa interes, bashkëshortit të saj, z. E. B. (i cili aktualisht ndodhet në ShBA).

Komisioni në kuadër të hetimit çmoi se duhet të vlerësoje me dokumentacion ligjor analizën e burimit të ligjshëm të të ardhurave të z. E. B. deri në nëntor të vitit 2004, kohë në të cilën ka lindur marrëdhënia e huas. Në bazë të ligjit, subjektit i është kërkuar pikërisht dokumentacioni për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të z. E. B. .

Per sa më sipër, subjekti ka deklatuar se :

*“Shetasi E. B. së bashku me familjen e tij kanë ushtruar dhe vazhdojnë të ushtrojnë aktivitetin privat në qytetin e Kukësit. Në shoqërinë huamarrëse \*\*\* ka patur të depozituar shumë prej 1 785 000 (një milion e shtatëqind e tetëdhjetë e pesë mijë) lekë. Këtë shumë ky shtetas e ka tërhequr nga kjo kompani fakt i cili provohet me përgjigjen e kërkesës nr. \*\*\* prot. datë 12.03.2019 Shoqëritë huamarrëse në Administrim. Gjithashtu pasuritë e tij përbëhen nga:*

- një punishte e prodhimit të llokumave në zonën industriale me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*;
- një dyqan në lagjen nr. \*\*\* me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*;
- godinë shërbimi një kat me sipërfaqe totale 580 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*;
- pasuria me emërtimin truall (2 kate nën çati) me sip. 260 m<sup>2</sup>... lagja \*\*\*, z.k. \*\*\*.

*Nga ekstrakti historik i të dhënave të regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit ‘person fizik’, familja e shtetasit E. B. vazhdon të jetë i rregjistruar si person fizik me aktivitet.*

*Bashkalidhur do ju vë në dispozicion shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.3.2019, të shoqëritë huamarrëse në administrim, katër vërtetime të datës 11.3.2019 lëshuar nga ZVRPP-ja Kukës, ekstrakti historik i regjistrit tregtar, si dhe një certifikatë familjare të këtij shtetasi”.*

Nga analiza e dokumentacionit të depozituar nga subjekti nuk rezultoi që z. E. B. të ketë ushtruar një veprimtari e cila të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të tij në momentin e dhënies së huas.

Për sa më sipër, nga analiza e dokumentacionit të administruar në dosje, nga deklaratimet e dhëna dhe provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni konstatoi se:

- Subjekti i rivlerësimit nuk ka vënë në dispozicion dokumentacion ligjor të mjaftueshëm për të vërtetuar burimin e ligjshëm me të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar huan e dhënë në vlerën prej 15.000 euro për personat e tjerë të lidhur E. dhe M. B. .
- Nuk rezulton e provuar me dokumentacion transferimi faktik i huas në vlerën 15.000 euro nga huadhënësi, personi tjetër i lidhur te personi i lidhur.

Në analizë të burimit të ligjshëm të të ardhurave për personin tjetër të lidhur, z. K. D., Komisioni çmoi se në bazë të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, subjekti kishte detyrimin për të provuar me dokumentacion të ligjshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave të personave të tjerë të lidhur.

Për këtë arsye subjekti është pyetur i cili është shprehur se: *“Si burim të ligjshëm të të ardhurave të tij huadhënësi K. D. si njëri nga aksionerët e Shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., deklaronte se i ka krijuar nga puna si emigrant në Greqi, si dhe të ardhura nga puna e tij pranë shoqërisë “\*\*\*”sh.p.k.”*

Në të njëjtën kohë për të vërtetuar të ardhurat e huadhënësit, subjekti ka depozituar vërtetim për punësimin e z. K. D. për periudhat: 1.2.2001 – 31.12.2001; 1.1.2004 – 31.12.2004; 1.1.2006 – 30.6.2007 dhe 1.7.2008 – 31.12.2010.

Komisioni çmon se, për procesin e rivlerësimit, me interes janë burimet e ligjshme të të ardhurave të tij deri në vitin 2004. Nga vërtetimet e vëna në dispozicion, rezultoi që personi tjetër i lidhur ka qënë në marrëdhënie pune, por nuk rezultoi të provohet se sa ka qënë paga.

Për sa më sipër, nga analiza e dokumentacionit të administruar në dosje, nga deklaratimet e dhëna dhe provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni konstatoi se:

- Subjekti i rivlerësimit nuk ka vënë në dispozicion dokumentacion ligjor të mjaftueshëm për të vërtetuar burimin e ligjshëm të të ardhurave, për të justifikuar huan e dhënë në vlerën prej 3.000 euro nga personi tjetër i lidhur, z. K. D. .
- Nuk rezultoi të provuar me dokumentacion shkresor transferimi faktik i huas në vlerën prej 3.000 euro nga huadhënësi, personi tjetër i lidhur te personi i lidhur.
- Subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme të të ardhurave për të krijuar pasurinë e analizuar në vitin 2004, apartament banimi ndodhur në Rr. “\*\*\*”.

Në lidhje me këto rezultate hetimi, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën. Mbi sa iu njoftua si rezultat hetimi nga Komisioni, subjekti ka depozituar me shkrim kundërshtime dhe objeksione të cilat nuk ndryshonin qëndrimin e mbajtur gjatë hetimit administrativ. Këto qëndrime subjekti i shprehu edhe në seancë dëgjimore.

Sipas subjektit të rivlerësimit: *“ .... me ‘moment pronotimi’ kam pasur në konsideratë vitin kur është bërë prenotimi dhe pagimi i vlerës së përcaktuar në këtë marrëveshje mes palëve, pra, vitin 2004.*

*Kam konsideruar si kohë të pagesës vitin financiar të deklaratimit të pasurisë dhe jo një datë konkrete, sepse siç ju jeni në dijeni, deklaratimet tona kanë qënë gjithmonë periodike vjetore, pra, me bazë vjetore dhe jo me datë veprimesh financiare. Këtë e provon edhe fakti se pikërisht në këtë kontratë sipërmarrje, është përcaktuar si kohë e likuidimit të këstit të parë data 25.4.2004 dhe jo data e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes që është më 18.3.2004, apo e thënë ndryshe ‘momenti i prenotimit’ siç është interpretuar nga ana Juaj shprehja ime në përgjigje të pyetësorit...”*

Në vlerësim për sa më sipër, Komisioni konkludon se pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk qëndron. Nisur nga referimi dhe interpretimi i përcaktuar në nenin 681 të Kodit Civil (interpretimi i kontratës bazuar në qëllimin e vërtetë që kanë ndjekur palët), si dhe bazuar në formulimin e gjetur në kontratë, po aq sa edhe nga sqarimi i dhënë nga subjekti i rivlerësimit gjatë pyetësorëve 2 dhe 3, nuk rezultoi asnjë përcaktim që me shprehjen “momenti i prenotimit” të identifikohet nga palët ndonjë një periudhë “një vjeçare”, që sipas pretendimit të subjektit nuk ka ndodhur në momentin e nënshkrimit të kontratës. Në fakt, subjekti nuk jep asnjë shpjegim se kur ka ndodhur prenotimi, ngjarje e cila faktikisht ka një moment konkret të përcaktuar në dokumentin shkresor në fjalë.

Gjithashtu, në lidhje me rezultatin e hetimit mbi aftësitë financiare të dy personave të tjerë të lidhur, E. R. B. dhe K. (K.) I. D., subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar duke sqaruar se kanë pasur të ardhura nga puna dhe nga shitja e pasurive të paluajtshme në qytetin e Kukësit (konkretisht, shtetasi E. B. i shtetasi I. E. një apartament dhe një dyqan në vitin 2000).

Në shpjegimet e dhëna me shkrim, si dhe në seancë dëgjimore, subjekti e mbështet dokumentacionin e vënë në dispozicion nga DRSSh-ja Kukës dhe nga ZVRPP-ja Kukës.

Në vlerësim për sa më sipër, Komisioni konkludon se pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk qëndron. Rezultati i hetimit u bazua në mungesën e dokumentacionit ligjor që provonte dhënien hua të një shume të konsiderueshme, si dhe në mungesën e dokumentacionit provues të gjendjes financiare të huadhënesave dhe pamundësisë për të dhënë hua me burime të ligjshme.

Sipas ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin që të provojë këto dy elementë, pra, të ardhura të mjaftueshme dhe të siguruara nga burime të ligjshme, si dhe transferimin e tyre te subjekti i rivlerësimit. Këtë detyrim subjekti i rivlerësimit e ka pasur të ditur dhe të qartë që në fillim, por pavarësisht kësaj rrethane, si gjatë në hetimit administrativ dhe pas njoftimit të rezultatit të hetimit, nga subjekti është vënë në dispozicion dokumentacion jo relevant, pasi në to referoheshin të ardhura nga punësimi që nuk i përkisnin periudhës së dhënies së huas.

Konkretisht, për shtetasin K. D. subjekti deklaroi se: *“...është bashkëfshatar i bashkëshortit tim, si dhe njëri nga tre vëllezërit e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me aktivitet të mbyllur në vitin 2018. Nga vëllezërit D. është krijuar shoqëria tjetër “\*\*\*\*”, ku z. K. D. është njëri nga bashkëpronarët me 30 % të aksioneve. Shoqëria “\*\*\*\*” nënkupton se të tre vëllezërit janë bashkëpronar të saj pamvarsisht rolit të tyre në administrimin e saj, por aktualisht për arsye sigurimesh njëri është shënuar si pronar dhe njëri është paraqitur si magazinier. Kjo shoqëri nga “\*\*\*\*” ka ndryshuar emrin në shoqërinë tjetër “\*\*\*\*”, ku z. K. D. është njëri nga bashkëpronarët me 30 % të aksioneve dhe kjo tregon se mundësitë ekonomike të tij si njëri nga tre bashkëpronarët e kësaj shoqërie ishin të mjaftueshme për të na huazuar sasinë prej 3 000 Euro...”*

Për këtë pretendim, subjekti u bazua në ekstraktin e lëshuar për shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. nga QKB-ja.

Në vlerësim për sa më sipër, Komisioni konkludon se pretendimi i subjektit nuk qëndron, pasi, subjekti ka vënë në dispozicion një dokument nga QKB-ja, që referon vetëm faktin e përbërjes së ortakërisë së shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., ku rezulton të jetë edhe shtetasi K. D., por jo dhe të ardhurat e tij. Nëse subjekti i rivlerësimit pretendon se të ardhurat e shtetasit K. D. burojnë nga shoqëria ku është i punësuar dhe njëkohësisht edhe ortak, atëherë, të ardhurat nga kjo shoqëri mund të rezultojnë nga dy burime: së pari nga paga nga magazinier, së dyti nga dividendi që shpërndan shoqëria në fund të çdo viti ushtrimor, pas miratimit të pasqyrës financiare dhe bilancit, si dhe pas likuidimit të të gjitha detyrimeve me natyrë fiskale.

Sa më sipër, në përfundim të procesit të rivlerësimit nuk u vërtetuan të ardhura të dokumentuara të shtetasit K. D., si rrjedhim nuk u vërtetua ligjshmeria e burimit të huas prej 3000.

Në vijim të prapsimeve, në rastin e mundësisë financiare të personit tjetër të lidhur, z. E. B., nga shitja e dy pasurive në Kukës, subjekti referon se pavarësisht se çmimi i shitjes së dy pasurive në fjalë ishte në total në vlerën 800.000 lekë, me deklaratën noteriale të vitit 2019 palët deklarojnë se në fakt çmimi real ka qenë në vlerën 1.400.000 lekë. Pra, subjekti bazohet në një deklaratë noteriale e cila ndryshon përmbajtjen e një dokumenti noterial të kohës me të cilin është realizuar marrëdhënia efektive e kalimit të pronësisë.

Për sa më sipër, nga analiza e dokumentacionit të administruar në dosje, nga deklaratimet e dhëna dhe provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, në përfundim të procesit, Komisioni arrin në konkluzionin se:

- Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë të vlerës së kësaj pasurie në deklaratën periodike të pasurive të vitit 2004.
- Subjekti ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për sa i përket burimit të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën “Vetting”.

- Subjekti ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie për shkak të një balancë negative në shumën **2.803.690 lekë**.

## **2. Garazh me sipërfaqe 34.65 m<sup>2</sup>, ndodhur në Rr. “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, blerë sipas kontratës datë 3.1.2009.**

Vlera 1.923.421 lekë. Pjesa takuese: 50%.

Burimi i krijimit: Sipas kontratës së huasë së datës 31.12.2008.

### **Faktet nga hetimi i administrativ kryesisht<sup>3</sup>**

Pasuria rezulton të jetë deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009: “*Garazhd me sip. 34.65 m<sup>2</sup> me nr. pasurie \*\*\*, Rr. “\*\*\*\*”, P. \*\*\*, Tiranë; 1.923.421,5 lekë; 50%*”.

Mbi mënyrën e kalimit të pronësisë së pasurisë ka konfirmuar edhe ZVRPP-ja Tiranë me dy përgjigjet e kthyer dhe me materialet shkresore bashkëlidhur, nga të cilat rezulton se në bazë të kontratës së shitblerjes nr. 1/1, datë 3.1.2009, subjekti dhe bashkëshorti kanë blerë nga bashkëpronarët e familjes “T.” (pronarë të tokës ku është ndërtuar pallati në Rr. “\*\*\*\*”) pasurinë “garazh”, regjistruar në ZVRPP-në Tiranë me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, në Rr. “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, Tiranë, kundrejt çmimit në vlerën 1.923.421 lekë, të likuiduara *cash* përpara nënshkrimit të kontratës. Në bazë të kësaj kontrate, ZVRPP-ja Tiranë ka lëshuar certifikatën e pronësisë nr. \*\*\*, datë 6.1.2009, në emër të bashkëpronarëve të rinj, subjekti dhe bashkëshorti).

### **Lidhur me këtë pasuri Komisioni hetoi në këto drejtime:**

#### **Lidhur me saktësinë e deklarimeve në vite dhe deklaratën “Vetting”**

Në analizë të deklaratimit të kësaj pasurie në vitin 2009, me deklaratën “Vetting” të vitit 2017, rezulton se subjekti ka deklaruar saktë pasurinë dhe të dhënat e saj.

#### **Lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie**

Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar se këtë pasuri e ka krijuar (blerë) me të ardhurat e realizuara nga kontrata e huasë së datës 31.12.2008, me huadhënëse D. L. (M.), huaja në vlerën 15.000 euro. Për këtë ka vënë në dispozicion kontratën e huasë nr. \*\*\*, datë 31.12.2008, nga e cila rezulton se huaja do të lëvrohet në datën 3.1.2009, me afat kthimi më 31.12.2011, pa interes.

Kontrata e huasë, si më sipër, nuk rezulton që të jetë deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike vjetore vitit 2008, por në atë të vitit 2009, në të cilën është shprehur: “*Hua për blerje garazhdi marrë sipas kontratës së huasë, datë 31.12.2008 me nr. \*\*\*, me datë lëvrimi 3.1.2009 – 31.12.2011 pa interes; (shuma e dhënë hua) 15.000 euro; (për t’u shlyer deri në fund të vitit 2009) 15.000 euro*”.

Mbi këtë fakt, subjekti ka dhënë sqarime në përgjigjet e pyetësorit 2, ku ka deklaruar se huaja u pasqyrua në deklaratën e vitit 2009, për shkak se shuma u mor në këtë vit dhe u likuidua në vitin 2011, fakt që është pasqyruar në deklaratën periodike të këtij viti (2011).

<sup>3</sup>Kërkesë nr. \*\*\* prot., datë 8.10.2018, drejtuar ZQRPP-së.  
ZVRPP Tiranë – kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 23.10.2018.  
Kërkesë nr. \*\*\* prot., datë 10.10.2018 – ZQRPP-së.  
ZVRPP Tiranë – kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 23.10.2018.

Nga deklaratimet e këtij pyetësi, konfirmohet lëvrimi i shumës, por jo dhe mënyra e këtij lëvrimi (bankë apo *cash*).

Bazuar në pikën 14, të nenit 3 dhe në pikën 3, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni çmoi se shtetasja D. L. (M.) plotëson kriteret ligjore për t'u kualifikuar si "person tjetër i lidhur", duke mbartur detyrimet që i ngarkon ligji për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

Për sa më sipër, Komisioni hetoi mbi të ardhurat e personit tjetër të lidhur, znj. D. L. (M.). Për këtë iu kërkua subjektit të vërë në dispozicion të Komisionit dokumentacion ligjor që provon të ardhura nga burime të ligjshme të realizuara nga personi tjetër i lidhur.

Në përgjigjet e pyetësit 2, subjekti ka dhënë sqarime mbi lidhjen familjare që ka më të, duke qenë motra e subjektit, si dhe mbi të ardhurat e realizuara nga bashkëshorti i huadhënës në emigracion dhe nga vetë huadhënsja në Shqipëri, duke e shoqëruar deklarin me dokumentacion të lëshuar nga: (i) DRSSH-ja Kukës (për të ardhurat e realizuara nga personi tjetër i lidhur nga punësimi në periudhën 2005); (ii) nga Zyra e Punës Kukës (për të ardhurat e realizuara nga personi tjetër i lidhur nga punësimi gjatë periudhës 2006 – 2007); si dhe (iii) nga autoritetet fiskale greke (pasqyrat IKA) (për të ardhurat e realizuara nga bashkëshorti i personit tjetër të lidhur gjatë periudhës 2002 – 2009)<sup>4</sup>. Këto dokumenta janë pjesë e fashikullit të akteve të dosjes.

Të dhënat e pasqyruara në dokumentacionin e mësipërm iu nënshtruan analizës ekonomike dhe pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

<b>Përshkrimi</b>	<b>2002</b>	<b>2003</b>	<b>2004</b>	<b>2005</b>	<b>2006</b>	<b>2007</b>	<b>2008</b>	<b>TOTAL</b>
Të ardhura bashkëshorti *** Greqi Euro	9,346	8,084	8,562	9,020	10,300	11,254	12,300	<b>68,866</b>
Të ardhura *** Greqi Euro							1,350	<b>1,350</b>
Taksa të paguara të dy bashkëshortët Euro					-45	-54	-270	<b>-369</b>
Qira Euro			-150	-150	-220	-220	-124	<b>-864</b>
Total të ardhura Greqi Euro	<b>9,346</b>	<b>8,084</b>	<b>8,412</b>	<b>8,870</b>	<b>10,035</b>	<b>10,980</b>	<b>13,256</b>	<b>68,983</b>
Të ardhura *** shuma mbi te cilat derdhet kontributi				208,720	36,680	26,200		<b>271,600</b>
<b>Total të ardhura</b>	<b>1,249,093</b>	<b>1,024,566</b>	<b>1,030,806</b>	<b>1,305,966</b>	<b>1,250,012</b>	<b>1,378,744</b>	<b>1,818,326</b>	<b>9,057,512</b>

Nga sa më sipër, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion dokumentacion të mjaftueshëm ligjor nga ku, bazuar në parimin e proporcionalitetit, Komisioni krijoi bindjen se personi tjetër i lidhur, znj. D. L. (M.), ka të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme për të krijuar shumën e dhënë hua prej 15.000 euro në fillim të vitit 2009.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, nga analiza e dokumentacionit të administruar në dosje, nga deklaratimet e dhëna dhe provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni arrin në konkluzionin se:

- Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë pasurinë në deklaratën "Vetting" të vitit 2017.

<sup>4</sup>Më hollësisht, shihni përgjigjet e pyetësit 2 dërguar me *e-mail* të datës 16.3.2019 ( në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 20.3.2019), si dhe dokumentacionin shoqëruar dërguar me *e-mail* të datës 16.3.2019 ( në komision me nr. \*\*\* prot., datë 20.3.2019).

- Nuk ka deklaruar në kohë në deklaratën periodike të pasurive të vitit 2008 marrjen e huas nga personi tjetër i lidhur, por kjo nuk ka sjellë pasoja sepse e ka deklaruar një vit më pas në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009.
- Subjekti kishte burime të ligjshme nga huaja në vlerën prej 15.000 euro, e dhënë nga personi tjetër i lidhur, për krijimin e kësaj pasurie.

### **3. Lokal me sipërfaqe 117 m<sup>2</sup>, ndodhur në Rr. “\*\*\*\*”, pallati “\*\*\*\*”, i prenotuar sipas kontratës së sipërmarrjes në datën 5.11.2003 dhe kontratës së shitjes së datës 30.12.2016.**

Vlera: 29.000 euro. Pjesa takuese: 25 %.

Burimi i krijimit: një pjesë e kredisë “Alpha Bank” në vitin 2006 dhe nga kontrata e dhurimit, datë 31.12.2005, nga babai i bashkëshortit i shpronësuar si pasojë e ndërtimit të aeroportit të Kukësit.

#### **Faktet nga hetimi i administrativ kryesisht<sup>5</sup>**

Nga hetimi rezulton se për herë të parë kjo pasuri është deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006: “*Pronotuar lokal nga bashkëshorti i pa hipotekuar në adresën Rruga “\*\*\*\*”. Ndërtuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sipërfaqja 158 m<sup>2</sup>. 58.000 euro 25 %*”. Më tej, në faqen “Të dhëna që nuk publikohen” (ose konfidenciale) të po këtij viti, subjekti ka deklaruar: “*Pronotuar lokali me kontratë provizore jonoteriale me firmën “\*\*\*\*”. Lokali është i pa regjistruar në hipotekë*”.

Sikurse më sipër, edhe në pjesën e deklaratës së personit të lidhur, në këtë vit (2006) është deklaruar mbi lokalin në fjalë: “*Lokal në (gjendje) karabina në Rr. “\*\*\*\*”, Pallati \*\*\* Tiranë sip. 158 m<sup>2</sup> i pa hipotekuar, është në ndërtim e sipër. Bashkëshorti është bashkëpronar me N. D.*”.

Nga përgjigjet e ZVRPP-së Tiranë, bazuar në kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 30.12.2016, konfirmohet transaksioni i shitblerjes së pasurisë “njësi” me sipërfaqe njësie 117 m<sup>2</sup>, sipërfaqe të përbashkëta (ballkone anësore) 53 m<sup>2</sup>, total 170 m<sup>2</sup>, regjistruar si pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, Tiranë, kundrejt çmimit 59.500 euro, për të cilën palët deklarojnë se e kanë likuiduar sipas kontratës së sipërmarrjes së datës 5.11.2003.

Sipas kontratës së sipërmarrjes së datës 5.11.2003 (bashkëlidhur përgjigjeve të ZVRPP-së Tiranë), palët kanë rënë dakort për blerjen e një dyqani me sipërfaqe 170 m<sup>2</sup> (me shkrim dore) kundrejt çmimit 350 euro/m<sup>2</sup> (me shkrim dore), total në vlerën 59.500 euro (me shkrim dore) të cilat do të likuidohen në tri këste: (1) kësti i parë është paguar në datën e nënshkrimit të kontratës (datë 5.11.2003), ku palët kanë shënuar përbri me shkrim dore shumën 30.000 euro; (2) kësti i dytë do të paguhet me mbarimin në tullë të katit ku ndodhet hyrja (kupto: dyqani), por edhe këtu palët kanë bërë shënimin me shkrim dore “*KARABINA*” dhe nuk kanë përcaktuar ndonjë shumë konkrete; (3) kësti i tretë me dorëzimin e çelësave. Në faqen e parë të kontratës konstatohen shënime me shkrim dore: “*mandatarkëtim nr. \*\*\*, datë 27/10 – 500.000 lekë = 3.690 euro*”, “*mandatarkëtimnr. \*\*\*, datë 5/11 26.310 euro*” dhe “*Σ 30.000 €*”

Sipas kontratës së sipërmarrjes së datës 5.11.2003 (pjesë e dokumentacionit justifikues të deklaratës “Vetting”, vënë në dispozicion nga subjekti), gjejmë të njëjtat vlera si në kontratën e depozituar në ZVRPP-së Tiranë, por, sipërfaqja prej 170 m<sup>2</sup>, çmimi njësi 350 euro/m<sup>2</sup>, vlera totale 59.500 euro janë të shtypura (jo me shkrim dore), ndërsa gjejmë me shkrim dore shënimet: “*mandatarkëtim nr. \*\*\*, datë 27/10 – 500.000 lekë = 3.690 euro*”, “*mandatarkëtim*

<sup>5</sup>Dokumentacioni i administruar ne dosjen e procesit të rivlerësimit

nr. \*\*\*, datë 5/11 – 26.310 euro” dhe “Σ 30.000 €”, ndërsa në pjesën fundore të faqes së parë shtohet shënimi: “*Pagoi sot më datë 26/05/2004, 20.000 (Njëzet mijë) Euro*”.

Kontrata e shitblerjes është realizuar në bazë të certifikatës së pronësisë nr. \*\*\*, datë 29.12.2016, në emër të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në të cilin nuk rezultojnë sipërfaqe të përbashkëta dhe as kuotë pjesëmarrje në to (rubrikat përkatëse janë pa shënim). Pra, në kontratën e shitblerjes janë përfshirë sipërfaqet e dy ballkoneve që palët i quajnë sipërfaqe të përbashkëta, por që gjithësesi u shiten blerësve në masën 100 %. Edhe në certifikatën e pronësisë së blerësve mungojnë këto elementë. Kjo kontratë referon si dokument ligjor pararendës të krijimit të të drejtave kontratën e sipërmarrjes, datë 5.11.2003, në të cilin palët kanë rënë dakort që të porositet një dyqan me sipërfaqe 170 m<sup>2</sup>, ku përfshihen edhe sipërfaqet e përbashkëta (në mënyrë orientuese në kontratë gjejmë: “*shkallët, ashensori, muret e brendshme, etj që parashikon ligji*”).

Sipas neneve 209 të Kodit Civil, janë përcaktuar në mënyrë orientuese objektet e përbashkëta në një ndërtesë: “*trualli mbi të cilin është ngritur ndërtesa, themelet, muret kryesore, muret ndarëse të brendshme, shkallët, hollet, çatia ose taraca, oxhaqet*”, duke vijuar me një dispozitë “*blanket*” për: “*të gjitha ato objekte të ndërtesës, që kanë karakter të tillë dhe shërbejnë për përdorim të përbashkët*”.

Në nenin 210 paragrafi i parë të Kodit Civil, është përcaktuar se: “*E drejta e secilit bashkëpronar mbi sendet e përmendura në nenin e mësipërm, është në përpjesëtim me vlefshërinë e katit ose të pjesëve të katit që i përkasin atij, përveç kur titulli parashikon ndryshe*”.

Pra, nëse pala shitëse do të kishte në pronësi sipërfaqe të përbashkëta të emërtuara “ballkone”, atëherë në lidhje me këto mund të ishte disponuar vetëm për një kuotë ideale pjesëmarrjeje në bashkëpronësi (çka nuk përbën objekt të një kontrate tipike të shitblerjes së pasurisë së paluajtshme) dhe jo objekt shitblerjeje në masën 100 %.

Faktin që, njësia e shitur në bazë të kontratës nr. \*\*\*, datë 30.12.2016, ka sipërfaqe 117 m<sup>2</sup> (dhe jo 170 m<sup>2</sup>) e vërteton certifikata e pronësisë. Fakti i përfshirjes në kontratë edhe i sipërfaqes prej 53 m<sup>2</sup> (ballkone të përbashkëta) është problem që lidhet me cenimin e sipërfaqeve të përbashkëta nëpërmjet zënies së tyre.

Bazuar në dokumentin justifikues kontratë sipërmarrjeje, datë 5.11.2003 (të vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, si dhe nga ZVRPP-ja Tiranë), konstatohet se palët porositëse janë personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit dhe shtetasi N. D. . Në këtë kontratë, palët porositëse nuk kanë përcaktuar ndonjë raport të veçantë lidhur me të drejtat dhe detyrimet ndaj njëri-tjetrit dhe të tyre ndaj palës investitore dhe më pas asaj shitëse (shoqëria e ndërtimit “\*\*\*\*” sh.p.k.), po kështu, as raporte kredie apo debie solidare. Për pasojë, në mungesë të klauzolave të posaçme në kontratën e sipërmarrjes që përcaktojnë një raport juridik të ndryshëm, Komisioni çmon se raporti mes porositësve në kontratë është ai i kredisë dhe i debisë në pjesë ideale të barabarta përballë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., pa qenë në raporte solidariteti përballë saj. Për pasojë, pagesat e shënuara në kontratën e sipërmarrjes (që ka depozituar shitësi në ZVRPP-në Tiranë, apo kopja e kontratës së sipërmarrjes që subjekti ka vënë në dispozicion të procesit vetting), janë kontribut i barabartë i të dy porositësve të kësaj kontrate.

Për më tepër, Komisioni çmon se personi i lidhur ka treguar vazhdimisht qëndrimin e tij në raport me sendin dhe sjelljen e tij në raport me të tretët si “pronar i vetëm” i sendit, veçanërisht në aktet juridike të nënshkruara prej tij. Në deklarin e tij në aktin noterial kontratë qiraje nr. \*\*\*, datë 6.10.2016, revokuar me aktin noterial “revokim kontrate qiraje” nr. \*\*\*, datë 21.11.2016, në nenin 1, pika 1.1, ka deklaruar se: “Qiradhënësi (I. M.) është pronari i një objekti (dyqan)...”. Gjithashtu, në nenin 2, pika 2.1. ka deklaruar se: “Qiradhënësi (I. M.) garanton që ai është i vetmi pronar ligjor i pronës.”

Duke qenë se në kontratën e sipërmarrjes dhe të shitblerjes krijohen interesa të posaçme pasurore të përbashkëta mes personit të lidhur dhe shtetasit N. D., Komisioni çmon se ky shtetas plotëson kriteret ligjore për t'u kualifikuar si "person tjetër i lidhur", bazuar pikën 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, duke mbartur subjekti detyrimet që i ngarkon ligji për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

Nga hetimi rezultoi e provuar se në deklaratimet periodike të viteve 2003 – 2005, kjo pasuri nuk është deklaruar edhe pse personi i lidhur kishte nënshkruar një kontratë sipërmarrje të datës 5.11.2003.

Komisioni çmon se subjekti kishte detyrimin për të deklaruar të drejtat reale mbi pasurinë, që në vitin 2003 (që është viti i krijimit të së drejtës reale ose i krijimit të raportit të posaçëm pasuror, sipas germës "a", të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, "*Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, te detyrimeve financiare te te zgjedhurve dhe te disa nepunesve publike*", sipas të cilit: "*Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.....: a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to*".

Nga krahasimi i deklaratimit të vitit 2006, me deklaratën "Vetting", rezultojnë mospërputhje sa i takon sipërfaqes së lokalit dhe vlerës së asetit: në vitin 2006 deklarohet lokal me sipërfaqe 158 m<sup>2</sup> në vlerën 58.000 euro, ndërsa në deklaratën "Vetting" deklarohet lokal me sipërfaqe 117 m<sup>2</sup> në vlerën 59.500 euro.

Për sa më sipër rezulton e provuar se subjekti ka bërë deklarinim të pasaktë duke fshehur të drejtën reale mbi këtë pasuri, pra, të krijimit të raportit pasuror bazuar në kontratën e sipërmarrjes në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003.

Nga hetimi ka rezultuar e provuar se në asnjë deklaratë periodike vjetore të pasurive dhe interesave nuk rezulton që të jetë deklaruar ndonjë dokument ligjor që rritë sipërfaqen ndërtimore të lokalit apo vlerën tij, sikurse as edhe për ndonjë marrëdhënie kredie apo debie që kompensohet me metra katrorë të shtuar në lokalin në fjalë.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion të procesit të rivlerësimit një kontratë të ndryshme nga ajo e depozituar nga pala shitëse në ZVRPP-në Tiranë, ku janë bërë shënime me shkrim dore pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 30.12.2016. Në të dyja kontratat e sipërmarrjes, duket se pagesat (cilado prej tyre) janë kryer në vitin 2003, pasi në shënimet "MA" (që nënkupton mandatarëkëtimin) jepen vetëm dita dhe muaji që lidhen me vitin e nënshkrimit të kontratës (2003), sikurse pagesa 20.000 euro shënohet sikur është kryer në datën 26.5.2004<sup>6</sup>. Gjithashtu, në asnjërën prej kontratave (të sipërmarrjes dhe të shitblerjes) nuk evidentohet personi që ka kryer efektivisht pagesën, ndërsa në shënimin për pagesën e shumës 20.000 euro, datë 26.5.2004, nuk evidentohet aspak mënyra e kryerjes (cash/bankë).

Në lidhje me sa më sipër, me anë të pyetësorit 2, Komisioni kërkoi shpjegime dhe sqarime nga subjekti, të cilat lidheshin me raportet egzistuese me personin tjetër të lidhur z. D., pagesat për lokalin, personi që i pagoi, burimin e ligjshëm të tyre, si dhe pasqyrimi i raporteve në deklaratat periodike vjetore përkatëse.

Në përgjigjet e pyetësorit 2, subjekti ka shpjeguar dhe sqaruar se pagesat janë kryer nga shtetasi N. D. (kumbari i djalit të subjektit) deri në momentin që personi i lidhur, bashkëshorti, përfiton një dhurim nga babai i tij në vlerën 4.000.000 lekë. Kjo vlerë u shtua edhe me një pjesë të

---

<sup>6</sup> Edhe në raportin e vlerësimit të hartuar nga ILDKPKI-ja, për shkak të këtyre shënimeve është arritur në konkluzionin se e gjithë vlera e pasurisë është likuiduar në vitet 2003 - 2004: "*pasi sipas kontratës së sipërmarrjes, lokali rezulton të jetë shlyer në vitet 2003 dhe 2004 (mbetur detyrim i pashlyer 4.750 euro)*"



kredisë që bashkëshorti i subjektit kishte marrë nga banka, në shumën 3.000.000 lekë, duke likuiduar një shumë totale prej 29.000 eurosh në vitin 2006<sup>7</sup>.

### **Lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie në deklaratën “Vetting”**

**Analize e burimit : Kontrata e dhurimit, datë 31.12.2005, nga babai i bashkëshortit i shpronësuar si pasojë e ndërtimit të aeroportit të Kukësit.**

Në deklaratën periodike të vitit 2005, subjekti ka deklaruar: *“Dhuratë e marrë prej bashkëshortit nga prindërit e tij sipas kontratës së dhurimit, datë 31.12.2005; (dhurues) I. M.; (lidhja me dhuruesin) babai; (shuma) 4.000.000 lekë”*.

Nisur nga ky deklaram, bazuar në pikën 14, të nenit 3, dhe në pikën 3, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni çmon se shtetasi I. M. plotëson kriteret ligjore për t’u kualifikuar si *“person tjetër i lidhur”*, duke mbartur detyrimet që i ngarkon ligji për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

Për sa më sipër, Komisioni kërkoi sqarime shtesë në lidhje me dhurimin e vjehrrit të subjektit dhe shqyrtoi dokumentacionin mbi të ardhurat e personit tjetër të lidhur, z. I. M. (vjehri), vënë në dispozicion nga subjekti, nga ku rezultoi se, bazuar në VKM-në nr. 95, në vlerën 20.2.2004, *“Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i aeroportit të Kukësit dhe i rrugëve të reja të tij”*, kishte përfituar dëmshpërblim në shumën 6.737.400 lekë. Sipas deklaramit të personit tjetër të lidhur<sup>8</sup>, këtë shumë e ka tërhequr *cash* në datë 29.4.2005, sipas mandatarkëtimit të kësaj date nr. \*\*\* (shuma 3.907.200 lekë) dhe në datën 16.6.2005, sipas mandatarkëtimit të kësaj date nr.\*\*\* (shuma 2.830.200 lekë)<sup>9</sup> të cilat i ka dhuruar tek i biri (personi i lidhur) në vitin 2005.

Nisur nga ky fakt, konstatohet se personi tjetër i lidhur ka pasur të ardhura nga burime të ligjshme që krijonin mundësinë e dhurimit në vlerën 4.000.000 lekë tek i biri (personi i lidhur) në vitin 2005.

### **Analize e burimit : Një pjesë e kredisë në “Alpha Bank” në vitin 2006**

Subjekti ka deklaruar si burim të dytë në blerjen e lokalit, pjesë nga një kredi në vlerën 3.000.000 lekë nga “Alpha Bank”, bazuar në kontratën nr. 1982, datë 18.7.2006, lidhur me “Alpha Bank”, nr. \*\*\*, datë 18.7.2006.

Pas verifikimit nga Komisioni, fakti i përfitimit të kredisë konfirmohet nga kjo bankë. Në bazë të kontratës së kredisë \*\*\*, datë 18.7.2006, subjekti dhe personi i lidhur kanë përfituar shumën 3.000.000 lekë<sup>10</sup>. Kredia në vlerën 3.000.000 lekë në “Alpha Bank” është disbursuar në llogarinë e bashkëshortëve Hajrie dhe I. M., në datën 18.8.2006, me përshkrimin *“blerje apartamenti”*<sup>11</sup>.

<sup>7</sup>Në pyetësorin 2, subjekti ka dhënë këtë përgjigje: *“... nga ana jonë nuk është kryer asnjë pagesë në vitin 2003 apo në vitin 2004 por vetëm në vitin 2006 pas përfitimit nga babai i bashkëshortit të një dhurate prej 4 000 000 (katër million lekë) si dhe një pjesë të kredisë të marrë në vlerën 3 000 000 (tremilion) lekë”*.

<sup>8</sup> Shihni, deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 6.5.2019 nënshkruar nga I. M., pjesë e dokumentacionit bashkëlidhur pyetësorit 3, regjistruar me nr. \*\*\* prot., datë 8.5.2019, në Komision.

<sup>9</sup>“Raiffeisen Bank” nuk ka dhënë informacion mbi veprime në emër të personit tjetër të lidhur, z. I. M. . Nga ana tjetër, në dokumentacionin që shoqëron përgjigjet e subjektit të rivlerësimit ndaj pyetësorit 3 të Komisionit, konstatohet se dokumentacioni ligjor i vjehrrit të subjektit mbi pronat e tij në Komunën Sh. si dhe mandatarkëtimit e veprimeve në këtë bankë përmbajnë emrin “H. M.” dhe jo “I. M.”.

<sup>10</sup> “Alpha Bank” nuk jep informacion për veprime përpara datës 2.3.2009.

<sup>11</sup> Shihni dokumentin e ILDKPKI-së: dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë, të deklaratës së pasurisë së subjektit Hajrie Muçmata, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.

Në datën 18.8.2006, personi i lidhur I. M. ka transferuar për shtetasin Sh. B., vlerën 2.970.000 lekë, me përshkrimin “*kalim nga I. M. për Sh. B. shlyerje detyrimi sipas kontratës së huamarrjes dt. 7.6.2006*”.

Subjekti është pyetur disa herë në lidhje me raportet që ka pasur me shtetasin Sh. B., si dhe marrëdhënien e detyrimit mes tyre<sup>12</sup>. Në përgjigje të pyetësorit 2, subjekti deklaroi se shtetasi Sh. B. është bashkëshorti i kushërirës së parë të nënës së saj (i vajzës së xhaxhait të saj), që aktualisht jeton në Boston, ShBA, dhe janë fqinj në pallatin nr. \*\*\*, në Rr. “\*\*\*\*”. Për sa i takon përshkrimin të veprimit bankar dhe raporteve me këtë person, subjekti mohon çdo lloj marrëdhënieje detyrimi monetar me të, duke mos vënë në dispozicion as dokumentacion ligjor që lidhet me deklarinin në transaksion duke deklaruar:

*“Unë nuk i kam marrë asnjë hua shtetasit Sh. B. . Për të mundësuar dhënien e kredisë nuk më kujtohet saktësisht se çfarë roli ka pasur në këtë kredi ky shtetas. Unë dhe bashkëshorti im kemi marrë pranë “Alfa Bank” kredi për investim, kredi të cilën e kam deklaruar dhe shlyer”.*

Ndërkohë lidhur me këtë marrëdhënie subjekti i rivlerësimit gjatë seancës dëgjimore ka mbajtur një qëndrim totalisht të ndryshëm nga ai gjatë procesit, duke shpjeguar:

*“Unë personalisht nuk kam nënshkruar ndonjë kontratë huaje. Është e vërtetë, kontrata e huas është nënshkruar nga bashkëshorti dhe shtetasi Sh. B., dhe në atë moment nuk disponoja kopjen e kësaj kontrate. Nuk mund t’i kërkoj llogari bashkëshortit tim pse nuk më sqaroi në atë moment lidhur me ekzistencën e kësaj kontrate në fakt, pasi unë dija që kishim marrë borxhin dhe ia dhamë Sh., por dija që lekët Sh. i kishim përdorur për të paguar vlerën 15 mijë euro dhe për të blerë lokalit në Kukës.*

*Domethënë është një marrëdhënie dymujore që mendova që ligji nuk më detyron mua për ta deklaruar, përderisa deklarimi im ishte deklarimi i kësaj kontrate kredie bankare të marrë pranë kësaj banke. Nëse banka do t’me jepte mua kredinë me shpejtësi, nuk do të isha e detyruar të merrja këtë borxh..”*

Gjithashtu, subjekti nuk deklaroi nëse (?), kur (?) dhe si (?) i është kthyer ndonjëherë nga shtetasi Sh. B. shuma e transferuar, duke mos deklaruar ndër vite edhe një kredi të kërkueshme ndaj këtij shtetasi. Nga ana tjetër, rezultoi se në vitin 2010, kredia është shlyer tërësisht, ku një pjesë e saj në vlerën prej 1.300.000 lekë është likuiduar nga personi tjetër i lidhur z. N. D.<sup>13</sup>.

Pas verifikimit të periudhës në fjalë, Komisioni konstaton se subjekti ka përfituar rregullisht pagën mujore në “Raiffeisen Bank” dhe nuk rezultoi ndonjë mungesë në punë për arsye shëndetësore, dhe për rrjedhojë, as edhe ndonjë pagesë për paaftësi të përkohshme në punë nga sigurimet shoqërore<sup>14</sup>.

Si përfundim, rezultoi e provuar se në vitin 2006, subjekti nuk ka pasur mundësi efektive për të përdorur një pjesë të kredisë nga “Alpha Bank”, si burim për të kryer pagesën për pjesën takuese të detyrimit në lidhje me çmimin e kontratës së sipërmarrjes së lokalit me shoqërinë

<sup>12</sup> Shihni, pyetësorin nr. 2.

<sup>13</sup> Sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 26.4.2016, shtetasi N. D. deklaroi se në mars 2010 ka derdhur në “Alfa Bank” vlerën 1.300.000 lekë për shlyerje kredie për llogari të z. I. M. dhe lekët i janë dhënë nga familja Muçmata. Derdhja në bankë është bërë nga N. D. për shkak të pamundësisë shëndetësore të I. dhe Hajrie Muçmata.

<sup>14</sup> Në “Raiffeisen Bank”: Hajrie Muçmata datë 12/02 kaluar shuma 36.858 lekë, datë 12/03 kaluar 94.503 lekë, datë 16/04 kaluar shuma 96.883 lekë.

“\*\*\*” sh.p.k., pasi shumën e marrë kredi nga kjo bankë e transferoi për një qëllim tjetër të shtetasi Sh. B. .

Komisioni çmon të vlerësojë mbi faktet që pasqyrohen në aktet e kohës kur janë kryer veprimet nga ku rezulton e provuar se lokali është porositur në bazë të kontratës së sipërmarrjes, nënshkruar në datën 5.11.2003, datë në të cilën palët kanë deklaruar se kanë likuiduar shumën 30.000 euro. Kjo shumë është likuiduar bashkërisht nga të dy porositësit dhe në mungesë të ndonjë dokumenti ligjor të kohës që përcakton një raport të ndryshëm nga ai që rrjedh nga zbatimi i dispozitave të ligjit (kapitulli i detyrimeve monetare në Kodin Civil), secila nga palët prezumohet të ketë kontribuar në pjesë të barabartë: 15.000 euro secili. Shënimet (me përmbajtje të njëjtë apo të shtuar) në secilën kontratë sipërmarrje (të depozituar në deklaratën “Vetting”, apo në ZVRPP-në Tiranë bashkë me kontratën e shitblerjes), duket se përbëjnë ndryshim të mëvonshëm të veprimeve dhe ndërhyrje mbi dokumentin bazë të pambështetur mbi dokumentacion ligjor provues (si psh: mandatpagese dhe pasqyrim i pagesës në librin e arkës apo të bankës së shoqërisë ndërtuese), të cilat nuk mund të jenë pjesë e analizës financiare.

Për sa më sipër, Komisioni kreu analizën financiare për aftësinë paguese të shumës 15.000 euro deri në datën 5.11.2003, bazuar vetëm mbi të ardhurat e realizuara nga subjekti dhe personi i lidhur nga burime të ligjshme, të deklaruara në deklaratën periodike përkatëse. Në këtë analizë është përfshirë dhe totali i likuiditeteve të deklaruara në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003 në shumën 26.200 USD, si në tabelën më poshtë:

<b>Pershkrimi</b>	<b>Shuma në lekë</b>
Te ardhura subjekti 1995-2003	3.207.228
Te ardhura bashkëshortja 1995-2003	3.498.860
<b>Total te ardhura</b>	<b>6.706.088</b>
Blere automjet tip Benz ne vitin 2001	800.000
Shpenzime jetese	1.584.780
<b>Diferenca e mundshme per kursim</b>	<b>4.321.308</b>
Paguar kest lokali 15.000 euro (pjesa e I. M.)	2.004.750
26200 USD ekuivalent ne lekë +200.000 lekë “Raiffeisen Bank”	3.047.678
<b>Diferenca</b>	<b>- 731.120</b>

Pra, subjekti i rivlerësimit në vitin 2003, nuk ka pasur mjete të mjaftueshme për të kontribuar në blerjen e pasurisë, për sa kohë personi tjetër i lidhur është nënshkruar i kontratës së sipërmarrjes. Ndryshe nga sa përmban kontrata e sipërmarrjes, subjekti nuk ka arritur të provojë të kundërtën dhe ta godasi vlerën provuese të saj.

Gjithashtu, konstatohet se subjekti nuk e ka kundërshtuar kontratën e sipërmarrjes as me ndonjë provë që do të provonte në mënyrë të pakontestueshme për pagimin e vlerës së pasurisë nga personi tjetër i lidhur në vitin 2003. Për këtë arsye, trupi gjykues në vlerësimin e tij i referohet përmbajtjes së kësaj kontrate sipërmarrjeje, e cila, së bashku me të gjitha provat e grumbulluara gjate hetimit administrativ, të çon në konkluzionin se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për sa i përket burimit të krijimit të kësaj pasurie.

Nga analiza ligjore dhe financiare duket se subjekti i rivlerësimit, bazuar në germën “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ka mungesë burimi financiar për të blerë pasurinë.

Në lidhje me këtë rezultat hetimi, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën. Mbi sa iu njoftua si rezultat hetimi nga Komisioni, subjekti ka depozituar me

shkrim kundërshtime dhe objeksione të cilat nuk ndryshonin qendrimin e mbajtur gjatë hetimit administrativ. Këto qëndrime subjekti i shprehu edhe në seancë dëgjimore.

Në kuadër të prapsimeve, subjekti deklaroi se: *“...Mes bashkëshortit tim dhe shtetasit N. D., i cili është dhe kumbari i djalit tim të vogël K., ishte rënë dakord që ky lokal do të blihej në bashkëpronësi mes tyre në masën 50 % me 50 %, por fillimisht vlera e 1/2 së tij do të paguhej nga shtetasi N. D. dhe pagesa nga ana jonë do të bëhej më vonë pasi ne të mund të krijojmë mundësinë ekonomike. Faktin se fillimisht kjo pagesë është bërë vetëm prej bashkëpronarit N. D. e deklaroi vetë shtetasi N. D. në deklaratën noteriale me nr. \*\*\*, datë 15.3.2019, në të cilën ka sqaruar si më poshtë: ‘... Deklaroj se jam iniciuesi i marrëdhënies kontraktuale me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k., për ndërtimin e një dyqani (njësi) me sipërfaqe totale 170 m<sup>2</sup> nga e cila sipërfaqe e shfytëzueshme 117 m<sup>2</sup>... pagesa e kësteve të para deri në shumën 30.000 euro janë bërë prej meje, ndërsa pagesa prej 29.500 euro është bërë prej bashkëporositësit tjetër I. M..”*

Në lidhje me këtë pretendim, Komisioni konkludon se subjekti i rivlerësimit mban qëndrim duke referuar një situatë të papërcaktuar në asnjë dokument të kohës, mbi të cilin bazohet raporti juridik i bashkëpronësisë (i të drejtave reale dhe i detyrimeve përkatëse). Për pasojë, për sa kohë nuk rezulton asnjë dokument që të ketë të përcaktuar se shtetasi N. D. kreu pagesën e parë në vlerën prej 30.000 euro (ç’ka sjell për pasojë lindjen e një detyrimi monetar të personit të lidhur I. M. për gjysmën e vlerës) dhe po kështu, për sa kohë që edhe nga subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur nuk është deklaruar asnjë detyrim në kuadër të pagesës së kontratës me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k., pretendimi i subjektit mbetet në nivel deklarativ, sepse mbetet i paprovuar fakti se të gjithë pagesën e ka likuiduar vetëm shtetasi N. D. . Kjo situatë, e mbështetur tërësisht në dokumentacionin e kohës, nuk mund të modifikohet me deklaratimet e mëpasshme.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit kundërshton vlerën provuese të kontratës së sipërmarrjes të vitit 2003, për të cilën shprehet: *“... 7. Kundërshtoj marrjen si provë dhe të analizuar nga Komision, duke kërkuar që të përjashtohet nga rrethi i provave, kontratën e sipërmarrjes, datë 5.11.2003, e gjendur dhe e sjellë si provë nga ZVRPP-ja Tiranë. Akti në formën që paraqitet, tregon se kemi të bëjmë me një kontratë të pa nënshkruar nga palët, pra kemi të bëjmë me një akt që nuk është në formën e kërkuar nga ligji dhe nuk dihet mënyra se si kjo kontratë e parregullt juridikisht të jetë futur në ZVRPP-në Tiranë. ...”*

Për sa më sipër, subjekti vuri në dispozicion të Komisionit, si provë të re në mbështetje të argumentave të paraqitur prej saj: deklaratën noteriale, datë 12.10.2019, të lëshuar nga administratori i shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., sipas të cilës rezulton se : *“... me kërkesën e z. I. M., pasi prej tij më është paraqitur një kopje e kontratës së sipërmarrjes e datës 5.11.2003, e cila ishte depozituar në ZVRPP-në Tiranë, për të cilën kërkohen shpjegimet e mia. Kjo kontratë rezulton të jete me dy fletë dhe pa nënshkrimet (firmat) e palëve (porositësve dhe sipërmarrësit). Kjo kopje kontrate nuk e di se nga kush është plotësuar, cili ka qenë qëllimi i plotësimit (pasi mbi të është punuar me shkrim dore mbi kontratat tip) dhe si ka përfunduar në ZVRPP-në Tiranë...”*

### **Në lidhje me këtë pretendim**

Pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk qëndron. Nga përgjigja e ZVRPP-së Tiranë me shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 23.10.2018 (në Komision me nr\*\*\*), rezulton që kontrata e sipërmarrjes datë 5.11.2003, është e nënshkruar nga të gjitha palët, sikurse edhe kontrata e vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, administruar nga ILDKPKI-ja.

Pretendimi se kontrata e sipërmarrjes, datë 5.11.2003, që është depozituar në ZVRPP-në Tiranë nuk përmban elementët e nënshkrimit, dhe si e tillë nuk vlen si provë, nuk ka lidhje me transaksionin, për sa kohë që, bazuar në dokumentin autorizim (noterial) i noterës M. Sh., është autorizuar punëmarrësi i saj z. L. N., që të kryejë të gjitha procedurat në ZVRPP-në Tiranë për regjistrimin e kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 31.12.2016. Ky shtetas rezulton që të ketë nënshkruar aplikimin në ZVRPP-n Tiranë në datën 17.1.2017, ku ka bashkëlidhur çdo dokument që është regjistruar në këtë pasuri.

Nga ana tjetër, duket qartë se bashkëlidhja e kësaj kontrate me atë të shitblerjes është bërë për një efekt të vetëm, për të provuar likuidimin e plotë të pagesës së çmimit dhe mënyrën e likuidimit të pagesës, pasi në faqe 2, paragrafi 3 është përcaktuar se çmimi prej 59.500 euro është likuiduar në bazë të kontratës së datës 5.11.2003.

Për sa më sipër, Komisioni mbështetet në materialet e vëna në dispozicion bashkëlidhur shkresave të ZVRPP-së Tiranë: shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 23.10.2018 si dhe me shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 23.10.2018.

Në procesin e vlerësimit përfundimtar të ceshtjes, nga analiza e dokumentacionit të administruar në dosje, nga deklarimet e dhëna dhe provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni arrin në konkluzionin se:

- Subjekti ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003 dhe në atë të vitit 2005, pasi nuk ka deklaruar të drejtat reale mbi asetin dhe as interesat e posaçme pasurore me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., si dhe as raportet e posaçme me shtetasit N. D. në vitin 2003.
- Subjekti ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006 dhe në deklaratën “Veting” lidhur me sipërfaqen e lokalit dhe vlerën e tij.
- Subjekti ka bërë deklaram të remë në deklaratën “Vetting” lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave për likuidimin e çmimit të lokalit, pasi kredia që përfitoi nga “Alpha Bank” nuk i kaloi shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., por shtetasit Sh. B. .
- Nisur nga kontrata e sipërmarrjes me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., rendin e pagesave sipas kësaj kontrate dhe analizën financiare, rezulton se subjekti nuk dispononte të ardhura të mjaftueshme dhe aftësi paguese për gjysmën e çmimit të kontratës realizuar në vitin 2003, në shumën 15.000 euro, pasi sipas analizës financiare ky vit rezulton me një diferencë negative në shumën 731.120 lekë.
- Subjekti ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006 pasi nuk ka deklaruar raportet e posaçme të huas me shtetasin Sh. B. në vitin 2006.

#### **4. Makinë e përdorur tip “Benz E-220 CDI” me targa \*\*\* e blerë në datën 24.1.2012.**

Vlera: 8.000 euro. Pjesa takuese: 50 %.

Burimi i krijimit: blerë me kursime nga paga dhe së apartamentit të fituar me trashëgimi.

#### **Faktet nga hetimi administrativ kryesisht<sup>15</sup>**

Pasuria rezulton që të jetë deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012: *“Blerje makine të përdorur tip Benz E-220 CDI me targë \*\*\* e blerë në datën 24.1.2012, sipas kontratës nr. \*\*\* (blerë me të ardhurat nga kursimet në vite); 8000 euro (tetëmijë); 50 %”*.

Nga përgjigja e DPSHTRr-ja rezulton se automjeti është blerë në bazë të kontratës nr. \*\*\*, datë 24.1.2012, në shumën 4.000 euro. Palët në kontratë deklarojnë se çmimi është likuiduar paraprakisht. Gjithashtu, dokumentacioni i automjetit përmban edhe deklaratën doganore, datë 25.1.2012, të nënshkruar nga personi i lidhur, ku rezulton se detyrimi për këtë automjet është

<sup>15</sup>Dokumentacioni hetimor në dosjen e procesit të rivlerësimit

në shumën 115.311 lekë. Pra, këtë vlerë të detyrimit doganor, rezulton që ta ketë likuiduar personi i lidhur.

Lidhur me këtë automjet, në rubrikën e të dhënave konfidenciale, subjekti deklaroi se makina sipas kontratës së shitjes është blerë 4.000 euro, por duke i shtuar sasisë së blerjes dhe pagesën e doganës, si dhe shërbimet e kryera në momentin e blerjes, goma + lysterje dhe disa shërbime të tjera, është deklaruar vlera e plotë që është harxhuar për vënien e saj në punë 8.000 euro<sup>16</sup>.

Nga sa më sipër, rezulton se subjekti ka deklaruar saktë pasurinë në deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe në deklaratën periodike vjetore .

### **Lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie**

Në lidhje me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për të likuiduar çmimin e automjetit dhe pagesën e detyrimit doganor, konstatohet se subjekti ka deklaruar si burim kursimet, por burimin e krijimit të tyre e ka deklaruar ndryshe në deklaratën periodike të vitit 2012 (*blerë me të ardhurat e krijuara nga kursimet në vite*) dhe ndryshe në deklaratën vetting 2017 (*Blerë me kursime nga paga dhe kontrata e shitjes së apartamentit të fituar me trashëgimi*). Në deklaratën vetting shtohet si burim: të ardhurat e fituara nga shitja e një apartamenti, të cilin subjekti e kishte fituar me trashëgimi.

Në mbështetje të këtij deklarimi, subjekti ka vënë në dispozicion dokumentin: vendim nr. \*\*\*, datë 1.11.2010, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, për lëshimin e trashëgimisë ligjore të trashëgimlënëses M. M. për trashëgimtarët ligjorë të rradhës së parë: fëmijët e saj Hajrie M. (Muçmata), D. M. dhe D. M. (L.), të cilët trashëgojnë nga 1/3 pjesë të pasurisë së saj. Ky vendim rezultoi që të jetë regjistruar në ZVRPP-në Kukës e cila ka lëshuar kartelën e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme në datën 2.11.2011, për pasurinë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, apartament banimi me sipërfaqe 78 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen \*\*\*, p. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, Kukës.

Bazuar mbi këtë dokumentacion, trashëgimtarët e të ndjerës M. M.: Hajrie M. (Muçmata), D. M. dhe D. M. (L.) kanë nënshkruar dokumentin: kontratë shitblerje nr. \*\*\*, datë 3.11.2011, nëpërmjet të cilit e shesin apartamentin në shumën 2.654.340 lekë, shumë të cilën deklarojnë se është likuiduar jashtë zyrës noteriale<sup>17</sup>.

Në deklaratën vjetore periodike të pasurive të vitit 2010, në rubrikën e të dhënave konfidenciale (pjesa e dhurimeve dhe trajtimeve preferenciale), subjekti ka deklaruar: “*Apartament banimi 2+1 në lagjen \*\*\*, Pall. \*\*\*, Shk. \*\*\*, Kukës*; (identiteti lidhja me personin nga i cili ka përfituar) *M. M. (nëna)*; (vlera) *1/3 (një e treta) e apartamentit*”.

Në deklaratën vjetore periodike të pasurive të vitit 2011, subjekti ka deklaruar: “*1. Shtuar vlera në lekë si pasojë e shitjes së apartamentit të fituar nga trashëgimia, apartamentet i cili ndodhej në Kukës, Lgj. \*\*\*, Pall. \*\*\*, Shk. \*\*\*, Ap. \*\*\* me sipërfaqe 78m<sup>2</sup>, në zonën kadastrale \*\*\*, sipas kontratës së shitjes nr. \*\*\*, datë 3.11.2011. Fituar 1/3 e vlerës së shitjes (vlera) 900.000 (nëntëqind mijë), (pjesa që zotëron) 100 %*”.

Për sa më sipër, Komisioni kreu analizën financiare për aftësinë paguese të shumës 8.000 euro deri në datën 25.1.2012, bazuar vetëm mbi të ardhurat e realizuara nga subjekti dhe personi i lidhur nga burime të ligjshme, të deklaruara në deklaratën periodike pararendëse përkatëse si dhe në bazë të dokumentacionit të siguruar nga hetimi administrativ.

Në datën 31.12.2011 gjendja e likuiditeteve *cash* dhe në bankë ka qenë në vlerën 1.345.631 lekë. Kjo shumë, e krijuar kryesisht nga shitja e pjesës takuese të apartamentit të trashëguar

<sup>16</sup> Shihni, në deklaratën “Vetting”, rubrika “Të dhëna konfidenciale”, faqe 8/1, deklarimi nr. 4.

<sup>17</sup> Shihni dy përgjigjet e ardhura nga ZVRPP-ja Kukës dhe materialet shpresore shoqëruese.

nga nëna është e mjaftueshme për të paguar vlerën e automjetit sipas kontratës dhe deklaratës doganore.

### **Nga sa më sipër rezulton e provuar se:**

Ka pasur mospërputhje në deklaratën periodike vjetore për vitin 2012 dhe deklaratën Vetting ne lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, pasi ne deklaraten Vetting, është shtuar burimi i krijimit te pasurise, fakt që e bën të pasaktë deklaratën Vetting, por që Komisioni nuk e cmoi me ndonjë pasojë për shkak se, sic rezultoi nga analiza financiare, deri në datën e pagesës së shumës 8.000 euro (datë 25.1.2012), subjekti i rivlerësimit disponon të ardhura të mjaftueshme dhe aftësi paguese për blerjen e automjetit.

### **5. Depozitë kursimi në “Union Bank” e subjektit në datën 23.11.2015.**

Vlera: 2.478.066,15 lekë, verifikuar gjatë hetimit administrativ nga Union Bank. Pjesa takuese: 50%.

Burimi i krijimit: të ardhura të krijuara nga shitja e banesës në Kukës sipas kontratës së datës 23.11.2015.

#### **Faktet nga hetimi i administrativ kryesisht<sup>18</sup>**

Depozita bankare rezulton që të jetë deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015: *“Të ardhura të krijuara nga shitja e banesës me nr. pasurie \*\*\*, me sipërfaqe 46 m<sup>2</sup> (e deklaruar më parë si pasuri në bashkëpronësi), sipas kontratës së shitjes nr. 4133/ 1543, 23.11.2015, të depozituara në llogari në Union Bank Kukës (vlera) 2.470.200 (dymilion e katërqind e shtatëdhjetë mijë e dyqind), (pjesa takuese) 50 %”*.

Sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 23.11.2015, subjekti dhe personi i lidhur kanë shitur pasurinë në fjalë në vlerën 2.470.200 lekë, e cila është paguar më parë nga blerësi në llogarinë bankare të noterit në “Union Bank”.

Ky apartament, është deklaruar fillimisht në deklaratën periodike të pasurive të vitit 2006: *“Blerë shtëpi banimi në Lagjen Nr. \*\*\* Kukës, z.k. \*\*\*, numri i pasurisë \*\*\* sip.46 m<sup>2</sup> lagje Nr. \*\*\*, pallati \*\*\*, shkalla \*\*\*, ap \*\*\*; (vlera) 850.000 lek, (pjesa takuese) 50 % (me bashkëshortin)”*. Në deklaratën e këtij viti, subjekti nuk ka deklaruar burimin e blerjes së apartamentit në Kukës në vlerën 850.000 lekë.

Sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 25.10.2006 subjekti dhe personi i lidhur kanë blerë pasurinë në fjalë në vlerën 850.000 lekë, të cilën e kanë likuiduar më parë jashtë zyrës noteriale.

Blerja dhe më pas rishitja e apartamentit në fjalë konfirmohet edhe nga përgjigjet e ZVRPP-së Kukës. Ndërsa shuma e deklaruar konfirmohet nga përgjigjet e “Union Bank”.

Komisioni hetoi dhe kreu analizën financiare në lidhje me aftësinë paguese të subjektit dhe të personit të lidhur, që me burimet e ligjshme të deklaruara deri në datën 25.10.2006 të mund të blinin apartamentin në vlerën 850.000 lekë, së bashku me deklarimin e pagesave të tjera të deklaruara deri në këtë datë, pasi ne ne vitin 2006 subjekti ka qënë me balancë pozitive.

Rezultati financiar për krijimin e depozitës në “Union Bank” pasqyrohet më hollësisht në tabelën analitike të analizës financiare për periudhën 2003 – 2016, në pjesën e fundit të këtij vendimi.

### **Nga faktet e konstatuara më lart, Komisionit i rezulton se:**

---

<sup>18</sup>Dokumentacioni perkatës në dosjen e procesit të rivlerësimit

- Subjekti ka deklaruar saktë depozitën në “Union Bank” dhe, po kështu edhe burimin e ligjshëm të të ardhurave për krijimin e depozitës.
- Subjekti ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006, pasi nuk ka deklaruar burimin e ligjshëm të të ardhurave për blerjen e apartamentit në vlerën 850.000 lekë, pasaktesi e cila nuk është cmuar me ndonjë pasojë për shkak se është vërtetuar burimi i ligjshëm i krijimit të kësaj shume.

#### **6. Depozitë kursimi për fëmijë në “Raiffeisen Bank”, filluar sipas kontratës së datës 18.3.2014 dhe gjendje deri në datën 16.1.2017.**

Vlera: 464.405 lekë, verifikuar gjatë hetimit administrativ nga Raiffeisen Bank. Pjesa takuese: 100%.

Burimi i krijimit: nga llogaria e pagës, çdo muaj në vlerën 15.000 lekë.

#### **Faktet nga hetimi i administrativ kryesisht<sup>19</sup>**

Depozita rezulton që të jetë deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014: “Depozita ‘Kursime për fëmijë’ e çelë më datë 18.3.2014, në emër të djalit K. M., me nr. \*\*\*, pranë Raiffeisen Bank; (shuma) 91.913 lekë (nëntëdhjetë e një mijë e nëntëqind e trembëdhjetë); (pjesa që zotëron) 100 %”. Në deklaratën e këtij viti, subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të depozitës në shumën 91.913 lekë.

Shuma e deklaruar në deklaratën “Vetting” konfirmohet nga përgjigjet e “Raiffeisen Bank”.

Komisioni hetoi dhe kreu analizën financiare në lidhje me aftësinë paguese të subjektit dhe të personit të lidhur, që me burimet e ligjshme të deklaruara deri në datën 18.3.2014 të mund të krijojnë depozitën në shumën 91.913 lekë, së bashku me deklaramin e pagesave të tjera të deklaruara deri në këtë datë, sikurse në tabelën e mëposhtme:

Nga analiza e lëvizjeve bankare të kësaj llogarie është konstatuar se kjo depozitë është krijuar dhe rritur, si në tabelën me poshtë:

VITI	2014	2015	2016
Gjendja në 31/12	91.913	264.979	449.556
Shtesa të vitit	91.913	173.066	184.577

Rezultati financiar për krijimin e depozitës në “Raiffeisen Bank” pasqyrohet më hollësisht në tabelën analitike të analizës financiare për periudhën 2003 – 2016, në pjesën e fundit të këtij vendimi.

#### **Nga faktet e konstatuara më lart, Komisionit i rezulton se:**

- Subjekti ka deklaruar saktë depozitën në “Raiffeisen Bank”.
- Subjekti ka pasur mundësi financiare për krijimin dhe zhvillimin e kësaj depozite.

#### **7. Depozitë kursimi në euro në “Credins Bank”, çelur në datën 25.3.2015. Gjendje deri në datën 16.1.2017.**

Vlera 15.153,32 euro, verifikuar gjatë hetimit administrativ nga Credins Bank. Pjesa takuese: 50%.

<sup>19</sup>Dokumentacioni perkates në dosjen e procesit të rivlerësimit.



Burimi i krijimit: kursimet nga të ardhurat nga paga e subjektit dhe bashkëshortit, si dhe të ardhurat nga qiratë të përshkruara në tabelën e të ardhurave.

#### **8. Depozitë kursimi në lekë në “Credins Bank”, çelur në datën 25.3.2015 dhe me gjendje deri në datën 16.1.2017.**

Vlera 1.021.396,98 lekë, verifikuar gjatë hetimit administrativ nga Credins Bank. Pjesa takuese: 50%.

Burimi i krijimit: nga kursimet nga pagat dhe të ardhurat e tjera të përshkruara në pjesën e të ardhurave.

#### **9. Depozitë kursimi në USD në “Credins Bank” depozituar, çelur në datë 25.3.2015 dhe gjendje deri më datë 7.10.2016.**

Vlera: 10.154,34 USD, verifikuar gjatë hetimit administrativ nga Credins Bank. Pjesa takuese: 50%.

Burimi i krijimit: nga kursimet nga pagat dhe të ardhurat e tjera të përshkruara në pjesën e të ardhurave.

#### **Faktet nga hetimi i administrativ kryesisht, për depozitat në “Credins Bank” (nr. 7, 8 dhe 9)<sup>20</sup>**

Nga hetimi rezulton se të tri depozitat: 1.000.000 lekë, 15.000 euro dhe 10.000 USD të krijuara nga gjendja *cash* e deklaruar deri në 2013 janë deklaruar për herë të parë nga subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014 me përshkrimin: “*Depozitë kursimi në Credins Bank me të ardhurat e krijuara ndër vite dhe të deklaruara më parë si gjendje cash në banesë*”.

Totali i gjendjes *cash* në banesë deri në fund të vitit 2014 sipas deklarimeve të subjektit ka qenë në vlerën 3.025.500 lekë. Ekuivalenti në lekë i depozitave të mësipërme është 4.331.377 lekë.

Shuma e deklaruar në deklaratën “Vetting” konfirmohet nga përgjigjet e “Credins Bank”.

Rezultati financiar për krijimin e depozitave në “Credins Bank” pasqyrohet më hollësisht në tabelën analitike të analizës financiare për periudhën 2003 – 2016, në pjesën e fundit të këtij vendimi.

#### **Nga faktet e konstatuara më lart, Komisionit i rezulton se:**

- Subjekti ka deklaruar saktë depozitat në “Credins Bank” (në lekë, euro dhe usd)
- Subjekti ka pasur mundësi financiare për krijimin e kësaj depozite.

#### **10. Gjendje në llogari rrjedhëse të bashkëshortit të subjektit, z. I. M., në “Credins Bank” me gjendje deri në datën 16.1.2017.**

Vlera 1.211.991 lekë, verifikuar gjatë hetimit administrativ nga Credins Bank. Pjesa takuese: 50%.

Burimi i krijimit: nga paga e bashkëshortit nga puna si Oficer i Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë Tiranë.

#### **Faktet nga hetimi i administrativ kryesisht<sup>21</sup>**

<sup>20</sup>Kërkesë nr.\*\*\*prot., datë 8.10.2018 – Bankave .  
Credins Bank – kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2019.  
Kërkesë nr. \*\*\* prot., datë 10.10.2018 – Bankave.  
Credins Bank – kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2019.

<sup>21</sup>Dokumentacioni perkatës në dosjen e procesit të rivlerësimit.

Në deklaratën periodike vjetore viti 2015 subjekti ka deklaruar: “*Kursime të krijuara nga të ardhurat e vitit 2015, gjendje në llogarinë rrjedhëse të bashkëshortit pranë Bankës Credins deri me dt 31.12.2015; (shuma) 531.124 lekë (pesëqind e tridhjetë e një mijë e njëqind e njëzetë e katër); (pjesa që zotëron) 50 %*”.

Shuma e deklaruar në deklaratën “Vetting” konfirmohet nga përgjigjet e “Credins Bank”.

Komisioni hetoi dhe kreu analizën financiare në lidhje me mundësinë e subjektit dhe të personit të lidhur, që me burimet e ligjshme të deklaruara deri në datën 16.1.2017 të mund të krijonin gjendjen në vlerën 1.211.991 lekë dhe konstatoi se kjo llogari në “Credins Bank”, është llogari page dhe të gjitha kreditimet e llogarisë për krijimin e shumës 1.211.991 lekë janë të ardhura të bashkëshortit të subjektit nga paga e tij nga Prokuroria e Rrethit Tiranë.

Rezultati financiar për gjendjen e llogarisë rrjedhëse në “Credins Bank” pasqyrohet më hollësisht në tabelën analitike të analizës financiare për periudhën 2003 – 2016, në pjesën e fundit të këtij vendimi.

#### **Nga faktet e konstatuara më lart, Komisionit i rezulton se:**

- Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë depozitën në “Credins Bank” dhe burimin e ligjshëm të krijimit të saj.

#### **11. Llogari rrjedhëse në “Alpha Bank” mbetur e hapur që nga momenti i mbylljes së kredisë ë datën 14.12.2010 me gjendje deri në datën 20.10.2016.**

Vlera 1.907,54 lekë, verifikuar gjatë hetimit administrativ nga Alpha Bank. Pjesa takuese: 50 %.

#### **Faktet nga hetimi i administrativ kryesisht<sup>22</sup>**

Marrëdhënien me “Alpha Bank” subjekti e deklaroi për herë të parë në deklaratën periodike të vitit 2006: “*Kredi në llogari rrjedhëse marrë nga Alpha Bank Tiranë’ për efekt blerje lokale. Numri i kredisë \*\*\* data e fillimit të kredisë 18.7.2006. Kredia është me afat 10-vjeçar. Shuma e kredisë së marrë është 3.000.000 (tre milionë) lekë me interes 3 % + normën e interesit të Bonove të Thesarit të bankës së shtetit. Likuidimi i kredisë është me këste 3 mujore. (shlyer deri në fund të vitit 2006) Shlyer kësti i parë me dt 20.10.2006 Σ=140.000 lek. Gjendja e detyrimit për kredinë e marrë në mënyrë progresive llogaritet nga vetë banka*”.

Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016 subjekti ka deklaruar: “*Llogari rrjedhëse në ‘Alpha Bank’, mbetur e hapur që nga momenti i mbylljes së kredisë në datën 14.12.2010 dhe gjendje deri në datën 31.12.2016 (gjendja) 1.613,77 lekë (një mijë e gjashtëqind e trembëdhjetë) (zotëron) 50 %*”.

Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, subjekti nuk ka deklaruar shlyerjen e kredisë me “Alpha Bank”.

Shuma e deklaruar në deklaratën “Vetting” konfirmohet nga përgjigjet e bankës “Alpha Bank”.

Në pikën e fundit të këtij vendimi pasqyrohet analizën financiare në vite në funksion të krijimit të pasurive, likuiditeteve dhe kryerjes së shpenzimeve për periudhën 2003 – 2016.

#### **Nga faktet e konstatuara më lart, Komisionit i rezulton se:**

- Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë gjendjen në “Alpha Bank” dhe po kështu edhe burimin e ligjshëm të të ardhurave për krijimin e gjendjes së lekëve në llogari rrjedhëse.

<sup>22</sup>Dokumentacioni përkatës në dosjen e procesit të rivlerësimit.

**12. Gjendje *cash* në banesë nga kursimet nga paga e subjektit dhe e bashkëshortit për periudhën 1.1.2016 – 31.12.2016.**

Vlera: 700.000 lekë. Pjesa takuese: 50 %.

PËRSHKRIMI		2016	Faktet nga hetimi i
<b>1</b>	<b>TË ARDHURA</b>	<b>2.303.585</b>	
	Të ardhura subjekti	1.374.299	
	Të ardhura bashkëshorti	929.286	
<b>2</b>	<b>SHPENZIME</b>	<b>1.386.934</b>	
	Shpenzime jetese	881.520	
	Shpenzime udhëtimi	302.509	
	Shpenzime shkollimi "****" dhe U.	202.905	
<b>3</b>	<b>KURSIME (SHITESA / PAKËSIME)</b>	<b>770.752</b>	
<b>DIFERENCA (TË ARDHURA -PASURI-SHPENZIME 1-2-3)</b>		<b>145.899</b>	

**administrativ kryesisht:**

Komisioni hetoi dhe kreu analizën financiare në lidhje me mundësitë financiare të subjektit dhe të personit të lidhur, që me burimet e ligjshme të deklaruara për periudhën 1.1.2016 – 31.12.2016, të mund të krijonte gjendjen *cash* në vlerën 700.000 lekë, së bashku me deklarimin e pagesave të tjera të deklaruara deri në këtë datë, sikurse në tabelën e mëposhtme:

**Nga faktet e konstatuara më lart, Komisionit i rezultoi se:**

- Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë gjendjen e kursimeve *cash* dhe po kështu edhe burimin e ligjshëm të të ardhurave për krijimin e gjendjes *cash*.
- Subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi që të krijojë gjendjen e kursimeve *cash* në vlerën 700.000 lekë.

Në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, bazuar në analizën financiare për të gjithë periudhën e rivlerësimit 2003 – 2016, të pasqyruar në tabelën në vijim, rezultoi e provuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur një balancë negative në vlerën prej **6.417.174 lekë**.

	1	2	3=1-2	4	5	6=4-3-5
<b>PËRSHKRIMI</b>	<b>PASURI</b>	<b>DETYRIME</b>	<b>PASURI NETO</b>	<b>TË ARDHURA DOKUMENTUAR</b>	<b>SHPENZIME</b>	<b>ANALIZA DOKUMENTUAR</b>
Para 2003	7 823 766	1 971 338	5 852 428	6 706 088	1 584 780	-731 120
2004	1 334 742	0	1 334 742	1 242 592	738 228	-830 378
2005	4 256 973	0	4 256 973	5 476 314	597 530	621 811
2006	-3 481 670	1 066 556	-4 548 226	1 568 110	1 600 975	4 515 361
2007	-441 058	-420 080	-20 978	1 485 664	897 217	609 425
2008	532 965	-413 305	946 270	1 531 086	834 807	-249 991
2009	3 148 264	1 667 593	1 480 671	1 644 193	842 145	-678 623
2010	4 159 845	-1 667 834	5 827 678	3 891 525	1 193 099	-3 129 253
2011	-1 249 122	-2 057 550	808 428	2 133 806	579 327	746 051
2012	1 921 921	92 973	1 828 948	2 163 549	825 424	-490 823
2013	1 090 206	-86 359	1 176 564	1 936 301	1 066 722	-306 985
2014	375 726	-6 614	382 340	2 175 183	1 171 146	621 696
2015	84 517	0	84 517	3 912 274	1 352 625	2 475 132
2016	770 752	0	770 752	2 303 585	1 386 934	145 899
<b>TOTAL</b>	<b>20 327 826</b>	<b>146 718</b>	<b>20 181 108</b>	<b>38 170 270</b>	<b>14 670 960</b>	
<b>Shuma e pambuluar me të ardhura të ligjshme</b>						<b>-6 417 174</b>

Gjate bisedimeve në procesin e vendimarrjes, trupi gjykues, arriti në përfundimin se:

(i) Subjekti i rivlerësimit, lidhur me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 117.5 m<sup>2</sup>, ndodhur në Rr. “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, Tiranë,

- ka bërë deklaram të pasaktë të vlerës së kësaj pasurie në deklaratën periodike të pasurive të vitit 2004.

- ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për sa i përket burimit të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën “Vetting”.

- ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie për shkak të një balancë negative në shumën 2.803.690 lekë.

(ii) Subjekti i rivlerësimit lidhur me pasurinë lokal me sipërfaqe 117 m<sup>2</sup>, Rr. “\*\*\*\*”, pallati “\*\*\*\*”;

-ka bërë deklaram pasakte në deklaratat periodike vjetore për vitet 2003 dhe 2004, pasi nuk ka deklaruar të drejtat reale mbi pasurinë dhe as interesat e posaçme pasurore me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., si dhe as raportet e posaçme me shtetasit N. D. në vitin 2003;

-ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006 dhe në deklaratën “Vetting”, lidhur me sipërfaqen e lokalit dhe me vlerën e tij;

-ka bërë deklaram të reme në deklaratën “Vetting” lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave për likuidimin e çmimit të lokalit, pasi kredia që përfitoi nga “Alpha Bank” nuk i kaloi shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., por shtetasit Sh. B.;

-nuk dispononte të ardhura të mjaftueshme dhe aftësi paguese për gjysmën e çmimit të kontratës të realizuar në vitin 2003, në vlerën 15.00 euro, pasi sipas analizës financiare ky vit rezultoi me një diferencë negative në vlerën 731.120 lekë;

-ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006, pasi nuk ka deklaruar raportet e posaçme të huas me shtetasin Sh. B. në vitin 2006.

(iii) Subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme të të ardhurave për të krijuar pasuritë dhe për të kryer shpenzimet për periudhën 2003 – 2016, duke rezultuar me një diferencë negative në vlerën 6.417.174 lekë.

## **V. KONKLUSIONE PËRFUNDIMTARE**

Në kuptim të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjekti ka bërë deklaratime të pasakta dhe të pamjaftueshme për kontrollin e pasurisë.

Subjekti rivlerësimi, znj. Hajrie Muçmata, nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë së saj dhe të personave të lidhur sipas parashikimeve të paragrafit 1 dhe 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

Subjekti rivlerësimi, znj. Hajrie Muçmata, nuk ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

Vendimarrja për subjektin e rivlerësimit zonjës Muçmata, është bazuar vetëm në kriterin e pasurisë, pavarësisht pretendimeve të saj për t'u vlerësuar për të tria kriteret, pasi me kalimin e barrës së provës, subjekti nuk arriti të vertetojë të kundërtën e konstatimeve të bëra prezent në rezultatet e hetimit në lidhje me këtë kriter, e për rrjedhojë, Komisioni krijoi bindjen që sipas parashikimit të pikës 2 të nenit 4 të ligjit 84/2016, përfundimet e arritura në mbarimin e procesit të rivlerësimit vetëm për kriterin e pasurisë, ishin të majftueshme për procesin e vendimarrjes.

Në përfundim, trupi gjyqësor i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, rekomandimet e relatorit të çështjes, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, mori në shqyrtim pretendimet e parashtruara dhe provat e paraqitura prej tij, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, sipas gërme "a", të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundim se subjekti i rivlerësimit, nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjyqësor i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar, në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të gërme "c", të pikës 1, të nenit 58, dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Hajrie Muçmata, me funksion gjyqtarë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 11.11.2019.

## **KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Firdes SHULI**  
**Kryesues**

**Pamela QIRKO**  
**Anëtar**

**Alma FASKAJ**  
**Relator**

Relatorja Alma Faskaj, është ne mungesë, pasi per arsye objektive, nuk ka qënë prezent në momentin e nenshkrimit të vendimit, ndërkohë që nënshkruar ne procesverbalin e vendimarrjes së trupës gjykuese të datës 08.11.2019.

*Sekretare gjyqësore*  
*Denisa Kosta*